



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 69

2003

Gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9105, datë 17.7.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara” dhe anekset e saj.....	3109
Dekret nr.3926, datë 1.8.2003	Për emërim të anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	3126
Vendim i Kuvendit nr.82, datë 28.7.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.....	3126
Vendim i Kuvendit nr.83, datë 28.7.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zonjës Ermelinda Mexsi në detyrën e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Integrimit.....	3127
Vendim i Kuvendit nr.84, datë 28.7.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të Ministrit të Integrimit.....	3127
Vendim i Kuvendit nr.85, datë 28.7.2003	Për mosmiratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Marko Bello në detyrën e Ministrit të Punëve të Jashtme.....	3128

Vendim i Kuvendit nr.86, datë 28.7.2003	Për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues të RTSH.....	3128
Vendim i Kuvendit nr.87, datë 31.7.2003	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	3129
Udhëzim i KQZ nr.2, datë 25.7.2003	Për një shtesë në udhëzimin nr.1, datë 11.7.2003 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Mbi procedurat e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2003".....	3132
Rregullore e Bankës së Shqipërisë	Për veprimtarinë valutore.....	3132
Udhëzimi nr.1 i Bankës së Shqipërisë	Mbi transfertat për veprimet tregtare në valutë.....	3139
Udhëzimi nr.2 i Bankës së Shqipërisë	Mbi transfertat e veprimeve jotregtare në valutë.....	3140
Rregullore e Bankës së Shqipërisë	Për licencimin e zyrave të këmbimit valutor.....	3141
	Shpallje kërkesë për shpronësimin me interes publik të objektit "Ndërtim i kanalit të ujërave të larta, Kotë, Vlorë".....	3143
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetasve Aida Ibrahim, Alda Ibrahimi dhe Erkan Ibrahim	3144

L I G J
Nr.9105, datë 17.7.2003

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR PRIVILEGJET
DHE IMUNITETET E AGJENCIVE TË SPECIALIZUARA” DHE ANEKSET E SAJ**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara” dhe anekset e saj.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3919, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA

**MBI PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E AGJENCIVE TË SPECIALIZUARA
(MIRATUAR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E KOMBEVE TË BASHKUARA MË 21
NËNTOR 1947)**

Ndërsa Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi më 13 shkurt 1946 një rezolutë që parashikonte unifikimin sa më të madh të mundshëm të privilegjeve dhe imuniteteve që gëzojnë Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e ndryshme të specializuara;

ndërsa janë zhvilluar konsultime ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të specializuara lidhur me zbatimin e rezolutës së sipërpërmendur;

rrjedhimisht me anë të rezolutës 179 (II) të miratur më 21 nëntor 1947, Asambleja e Përgjithshme ka miratuar Konventën e mëposhtme, e cila i është paraqitur agjencive të specializuara dhe çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara për pranim, si dhe çdo shteti tjetër anëtar i një ose më shumë agjencive të specializuara për hyrje në fuqi.

Neni 1

Përkufizimet dhe fushat e zbatimit

Seksioni 1

Në këtë Konventë:

(i) Fjalët “klausola standarde” i referohen dispozitave të neneve 2 deri në 9.

(ii) Fjalët “agjenci të specializura” nënkuptojnë:

- a) Organizatën Ndërkombëtare të Punës;
- b) Organizatën për Ushqimin dhe Bujqësinë në Kombet e Bashkuara;
- c) Organizatën për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën në Kombet e Bashkuara;
- d) Organizatën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar;
- e) Fondin Monetar Ndërkombëtar;

f) Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim;
g) Organizatën Botërore të Shëndetësisë;
h) Bashkimin Postar Botëror;
i) Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve;
j) Çdo agjenci tjetër që ka të bëjë me Kombet e Bashkuara në përputhje me nenet 57 dhe 63 të Kartës.

(iii) Fjala “Konventë” në lidhje me çdo agjenci të specializuar të veçantë, nënkupton klauzolat standarde siç modifikohen nga teksti final (ose i rishikuar) i shtojcës të përcjellë nga ajo agjenci në përputhje me seksionet 36 dhe 38.

(iv) Për qëllimet e nenit 3, fjalët “pronë dhe pasuri” do të përfshijnë gjithashtu pronat dhe fondet e administruara nga një agjenci e specializuar në ushtrimin e funksioneve të saj kushtetuese.

(v) Për qëllimet e neneve 5 dhe 7, shprehja “përfaqësuesit e anëtarëve” do të konsiderohet se përfshin të gjithë përfaqësuesit, përfaqësuesit alternativë, këshilltarët, ekspertët teknikë dhe sekretarët e delegacioneve.

(vi) Në seksionet 13, 14, 15 dhe 25 shprehja “mbledhje të zhvilluara nga një agjenci e specializuar” nënkupton mbledhjet: 1) e asamblesë së saj dhe të organit të saj ekzekutiv, (sido që të jetë emëruar); 2) të çdo komisioni të parashikuar në statutin e tij; 3) të çdo konference ndërkombëtare të mbajtur prej saj; 4) të çdo komiteti të çdonjërit prej këtyre organeve.

(vii) Termi “kreu ekzekutiv” nënkupton zyrtarin kryesor ekzekutiv të agjencisë së specializuar në fjalë, i caktuar ose jo “Drejtor i Përgjithshëm”.

Seksioni 2

Çdo Shtet Palë në këtë Konventë në lidhje me çdo agjenci të specializuar ndaj së cilës kjo Konventë është bërë e zbatueshme në përputhje me seksionin 37, do t'i njohë asaj ose në lidhje me atë agjenci, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në klauzolat standarde mbi kushtet e specifikuara në të dhe në ndonjë ndryshim të atyre klauzolave që përmbahen në dispozitat e shtojcës përfundimtare (ose të rishikuar), që lidhet me atë agjenci dhe të përcjellë në përputhje me seksionet 36 ose 38.

Neni 2

Personaliteti juridik

Seksioni 3

Agjencitë e specializuara, do të gëzojnë personalitet juridik. Ato do të kenë zotësinë:

- a) të lidhin kontrata;
- b) të fitojnë dhe zotërojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;
- c) të fillojnë procedura ligjore.

Neni 3

Pronat, fondet dhe pasuritë

Seksioni 4

Agjencitë e specializuara, pronat dhe pasuritë e tyre, kudo që të ndodhen dhe cilido qoftë mbajtësi i tyre, gëzojnë imunitet ndaj çdo forme procesi ligjor, përveç ndonjë rasti të veçantë në masën që ato kanë hequr dorë shprehimisht nga imuniteti i tyre. Megjithatë, është e kuptueshme se asnjëherë heqja dorë nga imuniteti, nuk do të shtrihet ndaj ndonjë mase ekzekutive.

Seksioni 5

Ambientet e agjencive të specializuara do të jenë të paprekshme. Pronat dhe pasuritë e agjencive të specializuara, kudo që të ndodhen dhe cilido qoftë mbajtësi i tyre, gëzojnë imunitet ndaj bastisjes, marrjes, konfiskimit, shpronësimit dhe ndaj çdo lloj forme tjetër ndërhyrjeje, qofshin këto veprime ekzekutive, administrative, gjyqësore ose legislative.

Seksioni 6

Arkivat e agjencive të specializuara dhe në përgjithësi të gjitha dokumentet që i përkasin ose

që mbahen prej tyre, janë të paprekshme kudo që ndodhen.

Seksioni 7

Pa qenë të kufizuara nga kontrollet financiare, rregulla ose pezullime të çdo lloji:

a) agjencitë e e specializuara mund të zotërojnë fonde, ar ose monedha të çdo lloji dhe të mbajnë llogari bankare në çfarëdolloj valute;

b) agjencitë e specializuara mund të transferojnë lirisht fondet e tyre, ar ose valutë nga një shtet në një shtet tjetër ose brenda një shteti tjetër dhe të konvertojnë çdo lloj valute të mbajtur prej tyre në çfarëdo lloj valute tjetër.

Seksioni 8

Çdo agjenci e specializuar në ushtrimin e funksioneve të saj në bazë të seksionit 7 të mësipërm, do t'u kushtojë vëmendjen e duhur përfaqësive të Shteteve Palë të kësaj Konvente, për aq sa konsiderohet se përfaqësive të tilla mund t'u jepet efekt pa dëmtuar interesat e agjencisë.

Seksioni 9

Agjencitë e specializuara, pasuritë e tyre, të ardhurat dhe pronat e tjera:

a) do të përjashtohen nga taksat direkte, megjithatë, kuptohet se agjencitë e specializuara nuk do të pretendojnë përjashtimin nga ato taksat të cilat në fakt janë vetëm detyrime për shërbimet e dobishme publike;

b) do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe ndalimet e kufizimit në import dhe eksport për artikujt e importuar ose eksportuar nga agjencitë e specializuara për përdorimin e tyre zyrtar, megjithatë kuptohet se artikujt e importuar me përjashtime të tilla nuk mund të shiten në vendin nga i cili janë importuar, me përjashtim të rasteve kur janë vendosur të njëjtat kushte nga qeveria e këtij vendi;

c) do të përjashtohen nga detyrimet, ndalimet dhe kufizimet për importet dhe eksportet në lidhje me botimet e tyre.

Seksioni 10

Megjithëse agjencitë e specializuara në parim nuk do të pretendojnë përjashtime nga detyrimet e akcizës dhe nga taksat e shitjes së pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat janë pjesë e çmimeve që do të paguhen, kur agjencitë e specializuara bëjnë blerje të rëndësishme për përdorim zyrtar të pasurisë në të cilin janë vënë ose mund të vihen detyrime dhe taksa të tilla, Shtetet Palë të kësaj Konvente, kur është e mundur, do të bëjnë rregullimet e duhura administrative për faljen ose kthimin e shumave të detyrimeve ose taksave.

Neni 4

Lehtësitë për komunikim

Seksioni 11

Çdo agjenci e specializuar do të gëzojë, në territorin e çdo Shteti Palë të kësaj Konvente sipas kësaj agjencie për komunikimet e veta zyrtare, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i dhënë nga qeveritë e këtyre shteteve ndonjë qeverie tjetër, përfshirë misionet e fundit diplomatike në fushën e prioriteteve, qirave dhe taksave në postë, telegrame, radiograme, telefonë dhe komunikime të tjera dhe vendosin tarifa për informacionin e shtypit dhe të radios.

Seksioni 12

Nuk mund të vendoset censurë në korrespondencën zyrtare dhe në komunikimet e tjera të agjencive të specializuara. Agjencitë e specializuara kanë të drejtën të përdorin kodet dhe të dërgojnë dhe marrin korrespondencë nëpërmjet korrierit, të cilat do të kenë të njëjtat imunitete dhe privilegje si korrierët dhe çantat diplomatike.

Asgjë në këtë seksion nuk mund të interpretohet në mënyrë që të ndalojë marrjen e masave të përshtatshme të sigurisë që do të vendosen me marrëveshje ndërmjet një Shteti Palë të kësaj Konvente dhe një agjencie të specializuar.

Neni 5 **Përfaqësuesit e anëtarëve**

Seksioni 13

Përfaqësuesit e anëtarëve në takimet e organizuara nga një agjenci e specializuar, ndërsa ushtrojnë funksionet e tyre dhe gjatë udhëtimeve për dhe nga vendi i takimeve, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitetet nga arrestimi ose ndalimi individual dhe sekuestrimi i bagazheve personale dhe në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe çdo akt i bërë sipas kompetencave të tyre zyrtare, imunitet nga një proces ligjor i çdo lloji;

b) paprekshmëria e të gjitha letrave dhe dokumenteve;

c) e drejta e përdorimit të kodeve dhe marrjes së letrave ose korrespondencave me anë të korrierit ose çantave të mbyllura;

d) përjashtimi i tyre dhe i bashkëshortëve të tyre nga kufizimet në lidhje me emigracionin, regjistrimin e të huajve ose detyrimeve kombëtare të shërbimit në shtetin në të cilin janë vizitorë ose gjatë kalimit transit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre;

e) të njëjtat lehtësi në lidhje me kufizimet monetare ose konvertimin, siç ju njihen përfaqësuesve të qeverisë të huaja në misionet zyrtare të përkohshme;

f) të njëjtat imunitete dhe lehtësi në lidhje me bagazhet personale, siç ju njihen anëtarëve të niveleve të krahasueshme të misioneve diplomatike.

Seksioni 14

Me qëllim sigurimin e një lirie të plotë në fjalimet dhe pavarësi të plotë në ushtrimin e detyrave të tyre për përfaqësuesit e anëtarëve të agjencive të specializuara në takimet e organizuara prej tyre, imuniteti nga procesi ligjor në lidhje me fjalën e folur dhe të shkruar dhe të gjitha aktet e bëra prej tyre gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre vazhdojnë t'ju njihen, pavarësisht se këta persona nuk janë më të angazhuar në ushtrimin e detyrave të tilla.

Seksioni 15

Ndërsa incidenti i çfarëdo forme të taksatimit varet nga vendbanimi, periudha gjatë së cilës përfaqësuesit e anëtarëve të agjencive të specializuara në takimet e organizuara prej tyre janë të pranishëm në shtetin anëtar për ushtrimin e detyrave të tyre, nuk do të konsiderohet si periudhë qëndrimi.

Seksioni 16

Privilegjet dhe imunitetet u jepen përfaqësuesve të anëtarëve, jo për përfitim personal të vetë individëve, por me qëllim që të ruajnë ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në lidhje me agjencitë e specializuara. Rrjedhimisht, anëtarë jo vetëm ka të drejtë, por edhe detyrë t'u heqë imunitetin përfaqësuesve të tij në çdo rast kur sipas mendimit të anëtarit, imuniteti do të pengonte ushtrimin e drejtësisë dhe kur ai mund të hiqet pa paragjykuar qëllimet, për të cilat imuniteti është dhënë.

Seksioni 17

Klauzolat e seksioneve 13, 14 dhe 15 nuk janë të zbatueshme në lidhje me autoritetet e shtetit, shtetasi i të cilit është kombëtar ose përfaqësues i të cilit është ose ka qenë.

Neni 6 **Zyrtarët**

Seksioni 18

Çdo agjenci e specializuar do të përcaktojë kategoritë e zyrtarëve ndaj të cilëve do të zbatohen klauzolat e këtij neni dhe të nenit 8. Ajo do t'ua komunikojë ato qeverive të të gjitha Shteteve Palë të

kësaj Konvente në lidhje me atë agjenci, si dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Emrat e zyrtarëve të përfshirë në këto kategori do t'u bëhen të njohur herë pas here qeverive të sipërpërmendura.

Seksioni 19

Zyrtarët e agjencive të specializuara:

a) do të kenë imunitet ndaj procesit ligjor në lidhje me fjalë të folura ose të shkruara, si dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në funksionet e tyre zyrtare;

b) do të gëzojnë të njëjtat përjashtime nga taksimi në lidhje me rrogat dhe pagesat që u bëhen atyre nga agjencitë e specializuara dhe me të njëjtat kushte që gëzohen nga zyrtarët e Kombeve të Bashkuara;

c) do të kenë imunitet së bashku me bashkëshortët e tyre dhe të afërmit që varen prej tyre, nga kufizimet e imigrimit dhe regjistrimit të të huajve;

d) do t'u jepen të njëjtat privilegje në lidhje me lehtësitë e shkëmbimit si ato që u jepen zyrtarëve të një rangu të krahasueshëm të misioneve diplomatike;

e) do t'u jepen, së bashku me bashkëshortët dhe të afërmit që varen prej tyre, të njëjtat lehtësi riatdhesimi në kohë krizash ndërkombëtare si zyrtarëve të një rangu të krahasueshëm të misioneve diplomatike;

f) do të kenë të drejtën të importojnë pa pagesë mobiljet dhe sendet e tyre në kohën e marrjes për herë të parë të postit të tyre në një vend të caktuar.

Seksioni 20

Zyrtarët e agjencive të specializuara do të përjashtohen nga detyrimet e shërbimeve kombëtare, me kusht që në lidhje me shtetet, shtetas të të cilëve ata janë, një përjashtim i tillë do të jetë i kufizuar për ata zyrtarë të agjencive të specializuara emrat e të cilëve, për arsye të detyrave të tyre, janë vendosur në një listë të përpiluar nga kryetari ekzekutiv i agjencisë së specializuar dhe janë miratuar nga shteti përkatës.

Nëse zyrtarë të tjerë të agjencive të specializuara do të thirren për shërbim, shteti përkatës, me kërkesë të agjencisë së specializuar përkatëse, do të shtyjë thirrjen e këtyre zyrtarëve për aq sa do të jetë e nevojshme për të shmangur ndërprerjen në vazhdimësinë e punës së tyre kryesore.

Seksioni 21

Përveç imuniteteve dhe privilegjeve të përcaktuara në seksionet 19 dhe 20, kryetari ekzekutiv të çdo agjencie të specializuar, duke përfshirë çdo zyrtar që vepron në emër të tij gjatë mungesës në detyrë, do t'i jepet atij, bashkëshortes dhe fëmijëve minorenë, privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet dhe lehtësitë që u jepen të dërguarve diplomatikë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Seksioni 22

Privilegjet dhe imunitetet u jepen zyrtarëve në interes vetëm të agjencive të specializuara dhe jo për përfitim personal të vetë individëve. Çdo agjenci e specializuar do të ketë të drejtën dhe detyrën t'i heqë imunitetin çdo zyrtari në ndonjë rast, kur, sipas mendimit të saj, imuniteti do të pengonte ushtrimin e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykuar interesat e agjencisë së specializuar.

Seksioni 23

Çdo agjenci e specializuar do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet përkatëse të shteteve anëtare për të lehtësuar administrimin e duhur të drejtësisë, për të siguruar respektimin e rregullave policore dhe për të ndaluar çdo abuzim në lidhje me privilegjet, imunitetet dhe lehtësitë e përmendura në këtë nen.

Neni 7

Abuzimet e privilegjeve

Seksioni 24

Nëse ndonjë Shtet Palë i kësaj Konvente konsideron se ka pasur një abuzim të një privilegji ose imuniteti të caktuar nga kjo Konventë, do të mbahen konsultime ndërmjet atij shteti dhe agjencisë së specializuar përkatëse për të vendosur nëse ka ndodhur ndonjë abuzim i tillë dhe nëse po për t'u

përpjekur të sigurojnë që nuk do të ndodhë ndonjë përsëritje. Nëse këto konsultime dështojnë të arrijnë një rezultat të pëlqyeshëm për shtetin dhe agjencinë e specializuar përkatëse, çështja nëse ka ndodhur një abuzim i një privilegji ose imuniteti do t'i paraqitet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në përputhje me seksionin 32. Nëse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë arrin në përfundimin se ka ndodhur një abuzim i tillë, Shteti Palë i kësaj Konvente, i prekur nga ky abuzim, do të ketë të drejtën, pas njoftimit të agjencisë së specializuar në fjalë, t'i ndalojë agjencisë së specializuar përkatëse përfitimet e privilegjit ose imunitetit të abuzuar në një mënyrë të tillë.

Seksion 25

1. Përfaqësuesve të anëtarëve në takime të zhvilluara nga agjenci të specializuara, ndërsa ushtrojnë funksionet e tyre dhe gjatë udhëtimeve të tyre për/dhe nga vendi i takimit, si dhe zyrtarëve sipas kuptimit të seksionit 18, nuk do t'u kërkohej prej autoriteteve kompetente të largohen nga vendi në të cilin po kryejnë funksionet e tyre për llogari të ndonjë aktiviteti të tyre në funksionin e tyre zyrtar. Sidoqoftë, në rastin e abuzimeve me privilegjet e selisë të kryera nga çdo person i tillë gjatë aktiviteteve në atë vend jashtë funksioneve të tij zyrtare, atij mund t'i kërkohej nga qeveria e atij vendi që të largohet me kusht që:

2.(I) Përfaqësuesve të anëtarëve ose personave që kanë të drejtën e imunitetit diplomatik sipas seksionit 21, nuk do t'u kërkohej të largohen nga vendi, përveçse në përputhje me procedurën diplomatike të zbatueshme për të dërguarit diplomatikë të akredituar në atë vend.

(II) Në rastin e një zyrtari për të cilin nuk është i zbatueshëm seksioni 21, nuk do të lëshohet asnjë urdhër për të lënë vendin, përveçse me miratimin e Ministrit të Jashtëm të vendit në fjalë dhe ky miratim do të jepet vetëm pas konsultimit me kryetarin ekzekutiv të agjencisë së specializuar përkatëse dhe, nëse janë ndërmarrë procedime dëbimi kundër një zyrtari, kryetari ekzekutiv i agjencisë së specializuar do të ketë të drejtën të paraqitet në këto procedime në emër të personit kundër të cilit kryhen ato.

Neni 8

Laissez-passer

Seksioni 26

Zyrtarët e agjencive të specializuara do të kenë të drejtë të përdorin laissez-passer të Kombeve të Bashkuara në përputhje me rregullimet administrative që do të bëhen ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe autoriteteve kompetente të agjencive të specializuara, të cilave mund t'u delegohen pushtetet e posaçme për lëshimin e laissez-passer. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë çdo Shtet Palë të kësaj Konvente për çdo rregullim administrativ të përfunduar në këtë mënyrë.

Seksioni 27

Shtetet Palë të kësaj Konvente do të njohin dhe pranojnë si dokumente të vlefshme udhëtimi laissez-passer të Kombeve të Bashkuara që u lëshohen zyrtarëve të agjencive të specializuara.

Seksioni 28

Aplikimet për viza, aty ku ato kërkohej, të zyrtarëve të agjencive të specializuara që mbajnë një laissez-passer të Kombeve të Bashkuara, kur shoqërohen nga një vërtetim se ato po udhëtojnë për punë të një agjencie të specializuar, do të shqyrtohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Përveç kësaj, këtyre personave do t'u sigurohen lehtësi për një udhëtim të shpejtë.

Seksioni 29

Lehtësi të ngjashme me ato të specifikuara në seksionin 28 do t'u jepen ekspertëve dhe personave të tjerë, të cilët, megjithëse nuk janë mbajtës të laissez-passer të Kombeve të Bashkuara, kanë një vërtetim se udhëtojnë për punë të një agjencie të specializuar.

Seksioni 30

Kryetarëve ekzekutivë, ndihmëskryetarëve ekzekutivë, kryetarëve të departamenteve dhe

zyrtarëve të tjerë, të një rangu jo më të ulët se kreu i departamentit të agjencive të specializuara, që udhëtojnë me laissez-passer të Kombeve të Bashkuara për punë të agjencive të specializuara, do t'u jepen të njëjtat lehtësi për udhëtim si ato që u akordohen zyrtarëve të një rangu të krahasueshëm në misionet diplomatike.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Seksioni 31

Çdo agjenci e specializuar do të parashikojë mënyra të përshtatshme për zgjidhjen:

a) e mosmarrëveshjeve që lindin nga kontratat ose mosmarrëveshje të tjera të karakterit privat, palë e të cilave është agjencia e specializuar;

b) e mosmarrëveshjeve që përfshijnë ndonjë zyrtar të një agjencie të specializuar, i cili për shkak të pozicionit të tij zyrtar gëzon imunitet, nëse imuniteti nuk është hequr në përputhje me klauzolat e seksionit 22.

Seksioni 32

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Konvente do t'i paraqiten Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, përveç ndonjë rasti kur është rënë dakord nga Palët që t'i drejtohen një mënyre tjetër zgjidhjeje. Nëse lindin mosmarrëveshje ndërmjet një agjencie të specializuar nga njëra anë dhe një anëtar i nën tjetër, do të bëhet një kërkesë për një opinion këshillimor mbi ndonjë çështje ligjore në fjalë në përputhje me nenin 96 të Kartës dhe nenin 65 të Statutit të Gjykatës, si dhe me klauzolat përkatëse të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe agjencisë së specializuar përkatëse. Opinioni i dhënë nga Gjykata do të pranohet prej Palëve si vendimtar.

Neni 10

Shtojcat dhe zbatimi ndaj agjencive të specializuara individuale

Seksioni 33

Në zbatimin e tyre për çdo agjenci të specializuar, dispozitat standarde do të veprojnë me ndonjë modifikim të parashtruar në tekstin përfundimtar (ose të rishikuar) të shtojcës që lidhet me atë agjenci, siç parashikohet në seksionet 36 dhe 38.

Seksioni 34

Klauzolat e Konventës në lidhje me ndonjë agjenci të specializuar duhet të interpretohen në kuadrin e funksioneve me të cilat kjo agjenci është ngarkuar nga instrumentet e saj statutore.

Seksioni 35

Projektshtojcat 1-9 u janë rekomanduar agjencive të specializuara të përmendura këtu, në rastin e ndonjë agjencie të specializuar, emri i së cilës nuk është përmendur në seksionin 1, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'i përcjellë agjencisë një projektshtojcë të rekomanduar nga Këshilli Ekonomik dhe Social.

Seksion 36

Teksti final i secilës shtojcë do të miratohet nga agjencia e specializuar në fjalë në përputhje me procedurat e saj statutore. Një kopje e shtojcës e miratuar nga çdo agjenci e specializuar do t'i paraqitet nga agjencia në fjalë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe do të zëvendësojë pas kësaj projektin të cilit i referohet seksioni 35.

Seksioni 37

Kjo Konventë bëhet e zbatueshme për secilën agjenci të specializuar kur t'i ketë transmetuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara tekstin final të shtojcës përkatëse dhe pasi ta ketë

informuar atë që pranon klauzolat standarde, të ndryshuara sipas kësaj shtojce dhe bie dakord të zbatojë seksionet 8, 18, 22, 23, 24, 31, 32, 42 dhe 45 (subjekt i ndonjë ndryshimi të seksionit 32, i cili mund të duket i nevojshëm, në mënyrë që ta bëjnë tekstin final të shtojcës në përputhje me instrumentet statutorë të agjencisë) dhe ndonjë klauzolë të shtojcës që përcakton detyrime për agjencinë. Sekretari i Përgjithshëm do t'u komunikojë të gjithë anëtarëve të Kombeve të Bashkuara dhe shteteve anëtare të agjencive të specializuara, kopje të vërtetuar të të gjitha shtojcave që i janë transmetuar sipas këtij neni dhe shtojcave të rishikuara sipas seksionit 38.

Seksioni 38

Nëse, pas dorëzimit të shtojcës finale sipas seksionit 36, ndonjë agjenci e specializuar miraton ndonjë ndryshim në përputhje me procedurat e veta statutorë, një shtojcë e ripunuar do t'i transmetohet nga vetë agjencia Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Seksioni 39

Klauzolat e kësaj Konvente në asnjë rast nuk duhet të kufizojnë ose të paragjykojnë privilegjet dhe imunitetet, të cilat i janë dhënë ose do t'i jepen nga ndonjë shtet ndonjë agjencie të specializuar, për arsye të vendosjes në territorin e tij të selisë ose të zyrave rajonale të saj. Kjo Konventë nuk duhet të pengojë konkluzionet e arritura ndërmjet një marrëveshjeje shtesë ndërmjet ndonjë Shteti Palë të kësaj Konvente dhe ndonjë agjencie të specializuar, që përshtat parashikimet e kësaj Konvente ose zgjeron, ose kufizon privilegjet dhe imunitetet e garantuara këtu.

Seksioni 40

Është e kuptueshme që klauzolat standarde, siç modifikohen nga teksti final i një shtojce i dërguar nga një agjenci e specializuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara sipas seksionit 36 (ose ndonjë shtojcë të rishikuar sipas seksionit 38) do të jenë në përputhje me klauzolat e instrumenteve statutorë në fuqi të agjencisë në fjalë dhe që, nëse ndonjë ndryshim i këtij instrumenti është i nevojshëm për bërjen e instrumentit statutor të përputhshëm, ky ndryshim duhet të ketë hyrë në fuqi në përputhje me procedurat statutorë të kësaj agjencie, përpara se shtojca finale (ose e rishikuar) të dërgohet.

Konventa nuk duhet të veprojë për të shfuqizuar ose për të mos zbatuar ndonjë klauzolë të instrumenteve statutorë të ndonjë agjencie të specializuar ose të ndonjë të drejte ose detyrimi të cilin agjencia mund ta ketë fituar ose ta ketë marrë përsipër.

Neni 11

Dispozitat përfundimtare

Seksioni 41

Aderimi në këtë Konventë nga një Shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe (subjekt i seksionit 42) nga një shtet anëtar i një agjencie të specializuar do të kryhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të një instrumenti aderimi, i cili do të hyjë në fuqi ditën e depozitimit.

Seksioni 42

Çdo agjenci e specializuar e interesuar do t'u komunikojë tekstin e kësaj Konvente së bashku me shtojcat përkatëse, anëtarëve të saj të cilët nuk janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara dhe do t'i ftojë ata të aderojnë në të, në lidhje me këtë agjenci, nëpërmjet depozitimit të një instrumenti aderimi në këtë Konventë Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së ose kreut të agjencisë së specializuar.

Seksioni 43

Çdo Shtet Palë në këtë Konventë do të përcaktojë në instrumentin e tij të aderimit agjencinë ose agjencitë e specializuara, në lidhje me të cilën ai angazhohet të zbatojë dispozitat e kësaj Konvente. Çdo Shtet Palë në këtë Konventë mundet që nëpërmjet një njoftimi të mëvonshëm drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të marrë përsipër të zbatojë dispozitat e kësaj Konvente për një ose më shumë agjenci të specializuara. Ky njoftim do të hyjë në fuqi ditën e marrjes

nga Sekretari i Përgjithshëm.

Seksioni 44

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo Shtet Palë në të lidhje me një agjenci të specializuar, kur ajo bëhet e zbatueshme për këtë agjenci në përputhje me seksionin 37 dhe kur Shteti Palë ka marrë përsipër të zbatojë dispozitat e kësaj Konvente në lidhje me këtë agjenci në përputhje me seksionin 43.

Seksioni 45

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të informojë anëtarët e Kombeve të Bashkuara, si dhe të gjithë anëtarët e agjencive të specializuara dhe drejtuesit ekzekutivë të tyre për depozitimin e çdo instrumenti aderimi të marrë në përputhje me seksionin 41 dhe për njoftimet e mëtejshme të marra sipas nenit 43. Drejtuesi ekzekutiv i agjencisë së specializuar do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe anëtarët e agjencisë në fjalë për depozitimin e ndonjë instrumenti aderimi sipas seksionit 42.

Seksioni 46

Është e qartë se, kur një instrument aderimi ose njoftim i mëvonshëm është depozituar në emër të një shteti, ky është i detyruar, sipas të drejtës së tij të brendshme të respektojë kushtet e kësaj Konvente, sikurse modifikohen nga tekstet përfundimtare të ndonjë shtojce që ka të bëjë me agjencitë për të cilat vepron ky aderim ose njoftim.

Seksioni 47

1. Subjekti i parashikimeve të paragrafëve 2 dhe 3 të këtij seksioni, çdo Shtet Palë i kësaj Konvente merr masa të zbatojë atë në lidhje me çdo agjenci të specializuar për të cilat ka kryer aderimin ose njoftimin e mëtejshëm deri në kohën kur një konventë ose shtojcë e rishikuar do të bëhet e zbatueshme për këtë agjenci dhe shteti në fjalë të ketë pranuar konventën ose shtojcën e rishikuar. Në rastin e një shtojce të rishikuar, pranimi i shteteve do të bëhet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të hyjë në fuqi ditën e marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Çdo Shtet Palë në këtë Konventë, i cili nuk është ose ka pushuar së qeni anëtar i një agjencie të specializuar, mund të paraqesë një njoftim me shkrim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe drejtorit ekzekutiv të agjencisë në fjalë, për faktin që ai ka për qëllim të refuzojë dhënien kësaj agjencie të përfundimeve nga kjo Konventë, që nga data e përcaktuar, e cila nuk duhet të jetë më përpara se tre muaj nga një data e marrjes së njoftimit.

3. Çdo Shtet Palë në këtë Konventë mund të refuzojë t'i japë përfitimet e kësaj Konvente ndonjë agjencie, e cila ka pushuar së pasuri marrëdhënie me Kombet e Bashkuara.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të informojë të gjitha shtetet anëtare në këtë Konventë për çdo njoftim që i është përcjellë, sipas parashikimeve të këtij seksioni.

Seksioni 48

Me kërkesën e një të tretave të Shteteve Palë në këtë Konventë, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të thërrasë një konferencë me qëllim rishikimin e saj.

Seksioni 49

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'i përcjellë kopje të kësaj Konvente çdo agjencie të specializuar dhe qeverive të çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara.

B. TEKSTI FINAL I ANEKSEVE

(Siç është aprovuar nga agjencitë e specializuara më dhjetor 1951)

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E PUNËS

Klauzolat standarde mbi Organizatën Ndërkombëtare të Punës do të aplikohen sipas dispozitave të mëposhtme:

1. Neni V (përveç paragrafit (c) të seksionit 13) dhe seksionit 25, paragrafët 1 dhe 2 (I), të nenit VII do të aplikohen edhe ndaj nëpunësve dhe punëtorëve, pjesëtarë të organeve drejtuese të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, si dhe ndaj zëvendësuesve të tyre, përveçse çdo imunitet do t'u hiqet këtyre personave, sipas seksionit 16 do të bëhet nga organet drejtuese.

2. Privilegjet, imunitetet, përjashtimet dhe lehtësimet të përcaktuara në seksionin 21 të klauzolave standarde gjithashtu do t'i njihen të gjithë zëvendësudrejtorëve të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, si dhe çdo asistent drejtor të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

3. (i) Ekspertët (të ndryshëm nga zyrtarët e përcaktuar nga objekti i nenit 6) që i shërbejnë ose kryejnë misione për komitetet e Organizatës do t'u njihen, deri në masën që do të jetë e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave të tyre, duke përfshirë këtu dhe kohën e nevojshme për udhëtime të lidhura me shërbimet për komitetet apo misionet, privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitet personal ndaj arrestit ose ndalimit të bagazhit të tyre;

b) në lidhje me shprehjen e mendimeve të tyre gojarisht apo nëpërmjet akteve të shkruara në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, kanë imunitet nga procese gjyqësore të të gjitha llojeve, imunitet i cili vlen edhe mbasi apo puna e tyre për Organizatën do të ketë përfunduar;

c) të njëjtat lehtësira në lidhje me limitime në shkëmbimin e parave dhe në lidhje me bagazhin e tyre personal, që i jepen zyrtarëve të qeverive të huaja, në mision zyrtar të përkohshëm;

d) paprekshmëria e dokumenteve të lidhura me detyrën që zhvillojnë për llogari të Organizatës.

(ii) Në lidhje me paragrafin (d) të pikës 3(i) më sipër, principi i përmbajtur në fjalinë e fundit të seksionit 12 të klauzolave standarde do të aplikohet.

(iii) Privilegjet dhe imunitetet janë të garantuara për ekspertët e Organizatës për interes të Organizatës dhe jo për përfitime personale të individëve.

Organizata ka të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetet e ekspertëve në çdo rast kur besohet se imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë, në rastet kur një gjë e tillë do të dëmtojte interesat e Organizatës.

ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR USHQIMIN DHE BUJQËSINË

Klauzolat standarde mbi Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (më poshtë e quajtur "Organizata") do të aplikohen sipas dispozitave të mëposhtme:

1. Neni 5 seksioni 25, paragrafi 1 dhe 2 (I) i nenit 7 do të aplikohen edhe ndaj Kryetarit të Këshillit të Organizatës, përveçse çdo heqje e imunitetit të kryetarit sipas seksionit 16 që do të vendoset nga Këshilli i Organizatës.

2. (i) Ekspertët (të ndryshëm nga zyrtarët e përcaktuar nga objekti i nenit 6) që i shërbejnë apo kryejnë misione për komitetet e organizatës do t'u njihen, deri në masën që do të jetë e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave të tyre duke përfshirë këtu edhe kohën e nevojshme për udhëtime të lidhura me shërbimet për komitetet apo misionet, privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitet personal ndaj arrestit apo ndalimit të bagazhit të tyre;

b) në lidhje me shprehjen e mendimeve të tyre gojarisht ose nëpërmjet akteve të shkruara në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, kanë imunitet nga procese gjyqësore të të gjitha llojeve, imunitet i cili vlen edhe mbasi apo puna e tyre për Organizatën do të ketë përfunduar;

c) të njëjtat lehtësira në lidhje me limitime në shkëmbimin e parave dhe në lidhje me bagazhin e tyre personal, që i jepen zyrtarëve të qeverive të huaja në mision zyrtar të përkohshëm;

d) paprekshmëria e dokumenteve të lidhura me detyrën që zhvillojnë për llogari të

^a Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm më 14 shtator 1948

Organizatës.

(ii) Në lidhje me paragrafin (d) të pikës 2 (i) më sipër, principi i përmbajtur në fjalinë e fundit të seksionit 12 të klauzolave standarde do të aplikohet.

(iii) Privilegjet dhe imunitetet janë të garantuara për ekspertët e Organizatës për interes të Organizatës dhe jo për përfitime personale të individëve.

Organizata ka të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetet e ekspertëve në çdo rast kur besohet se imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë, në rastet kur një gjë e tillë nuk do të dëmtonte interesat e Organizatës.

3. Privilegjet, imunitetet, përjashtimet dhe lehtësimet e përcaktuara në seksionin 21 të klauzolave standarde do t'i njihen dhe Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës.

Aneksi IIIc

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E AVIACIONIT CIVIL

Klauzolat standarde mbi Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (më poshtë e quajtur “Organizata”) do të aplikohen sipas dispozitave të mëposhtme:

2. Privilegjet, imunitetet, përjashtimet dhe lehtësimet të përcaktuara në seksionin 21 të klauzolave standarde gjithashtu do t'u njihen të gjithë zëvendës drejtorëve të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, si dhe çdo asistent drejtori të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

3. (i) Ekspertët (të ndryshëm nga zyrtarët e përcaktuar nga objekti i nenit 6) që i shërbejnë apo kryejnë misione për komitetet e Organizatës do t'u njihen, deri në masën që do të jetë e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave të tyre, duke përfshirë këtu dhe kohën e nevojshme për udhëtime të lidhura me shërbimet për komitetet apo misionet, privilegjet dhe imunitet e mëposhtme:

e) imunitetet personale ndaj arrestit apo ndalimit të bagazhit të tyre;

f) në lidhje me shprehjen e mendimeve të tyre gojarisht ose nëpërmjet akteve të shkruara në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, kanë imunitet nga procese gjyqësore të të gjitha llojeve, imunitet i cili vlen edhe mbasi apo puna puna e tyre për Organizatën do të ketë përfunduar;

g) të njëjtat lehtësira në lidhje me limitime në shkëmbimin e parave dhe në lidhje me bagazhin e tyre personal, që u jepen zyrtarëve të qeverive të huaja, në mision zyrtar të përkohshëm;

h) paprekshmëria e dokumenteve të lidhura me detyrën që zhvillojnë për llogari të Organizatës.

(ii) Në lidhje me paragrafin (d) të pikës 3(i) më sipër, principi i përmbajtur në fjalinë e fundit të seksionit 12 të klauzolave standarde, do të aplikohet.

(iii) Privilegjet dhe imunitetet janë të garantuara për ekspertët e Organizatës, për interes të Organizatës dhe jo për përfitime personale të individëve. Organizata ka të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetet e ekspertëve në çdo rast kur besohet se imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë, në rastet kur një gjë e tillë nuk do të dëmtonte interesat e Organizatës.

Aneksi IVd

ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ARSIMIN, SHKENCËN DHE KULTURËN

Klauzolat standarde, në lidhje me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, do të aplikohen sipas dispozitave të mëposhtme:

1. Neni 5, seksioni 25, paragrafi 1 dhe 2 (I) i nenit 7 do të aplikohen edhe ndaj Presidentit të Konferencës, ndaj anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të Organizatës, si dhe ndaj zëvendësve të tyre dhe këshilltarëve, përveçse çdo heqje e imunitetit të këtyre zyrtarëve të Bordit Ekzekutiv, sipas seksionit 16 do të vendoset nga Bordi Ekzekutiv.

^b Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm 13 dhjetor 1948

^c Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm 11 gusht 1948

^d Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm më 7 shkurt 1949

2. Zëvendësudrejtori i Përgjithshëm i Organizatës, bashkëshortja e tij dhe fëmijët e tij të mitur do të gëzojnë gjithashtu imunitet, përjashtimet dhe lehtësimet, të cilat i akordohen të dërguarëve diplomatik në bazë të së drejtës ndërkombëtare, që neni 6, seksioni 21 i Konventës i siguron drejtuesve ekzekutiv të agjencive të specializuara.

3. (i) Ekspertët (të ndryshëm nga zyrtarët e përcaktuar nga objekti i nenit 6) që i shërbejnë apo kryejnë misione për komitete të Organizatës do t'u njihen, deri në masën që do të jetë e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave të tyre, duke përfshirë këtu dhe kohën e nevojshme për udhëtime të lidhura me shërbimet për komitetet ose misionet, privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitet personal ndaj arrestit apo ndalimit të bagazhit të tyre;

b) në lidhje me shprehjen e mendimeve të tyre gojarisht ose nëpërmjet akteve të shkruara në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, kanë imunitet nga proceset gjyqësore të të gjitha llojeve, imunitet i cili vlen edhe mbasi puna e tyre për Organizatën do të ketë përfunduar;

c) të njëjtat lehtësira në lidhje me limitime në shkëmbimin e parave dhe në lidhje me bagazhin e tyre personal, që u jepen zyrtarëve të qeverive të huaja, në mision zyrtar të përkohshëm.

(iii) Privilegjet dhe imunitetet janë të garantuara për ekspertët e Organizatës, për interes të Organizatës dhe jo për përfitime personale të individëve

Aneksi Ve

FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

Në aplikimin e saj në lidhje me Fondin Monetar Ndërkombëtar (më poshtë i quajtur "Fondi") Konventa (përfshirë këtu dhe aneksi i saj) do të veprojë në bazë të dispozitave të mëposhtme:

1. Seksioni 32 i klauzolave standarde do të aplikohet vetëm për diferencat që lindin nga interpretimi ose aplikimi i privilegjeve dhe imuniteteve të cilat rrjedhin nga Fondi, vetëm sipas kësaj Konvente dhe nuk përfshihen në atë të përmbajtura në nenet e marrëveshjes së tij apo në dispozita të tjera.

2. Dispozitat e Konventës (përfshi këtu dhe aneksin) nuk modifikojnë ose kërkojnë modifikimin e neneve të Marrëveshjes së Fondit dhe nuk urdhërojnë, ose limitojnë ndonjë nga të drejtat, imunitetet, privilegjet apo përjashtimet të dhëna Fondit apo zyrtarëve të tij, si guvernatorëve, drejtorëve ekzekutivë, zëvendësve apo të punësuarëve sipas neneve të Marrëveshjes së Fondit ose të dispozitave të tjera.

Aneksi VI^f

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Në aplikimin e saj në lidhje me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (më poshtë e quajtur "Banka") Konventa (përfshirë këtu dhe aneksi i saj) do të veprojë në bazë të dispozitave të mëposhtme:

1. Sa më poshtë do të zëvendësojë seksionin 4:

"Veprimet kundër Bankës mund të ndërmerren vetëm para gjykatave kompetente të juridiksionit të territorit të një anëtarit të Bankës në të cilën Banka ka një zyrë përfaqësimi, ka caktuar një agjent për pranimin e shërbimeve ose ka lëshuar dhe garantuar sigurime. Megjithatë, asnjë veprim nuk duhet të ndërmerret nga anëtarë ose persona që veprojnë për to apo ankesa të rrjedhura prej anëtarëve. Pasuria dhe asetet e Bankës, kudo që të ndodhen dhe nga cilido që i mban, duhet të mbrohen nga të gjitha format e zotërimit, bashkimit ose ekzekutimit deri në vendimin e gjykimit përfundimtar ndaj Bankës".

2. Seksioni 32 i klauzolave standarde do të aplikohet vetëm për diferencat që lindin nga

^e Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm më 6 maj 1949

^f Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm më 29 prill 1949

interpretimi ose aplikimi i privilegjeve dhe imuniteteve të cilat rrjedhin nga Banka, vetëm sipas kësaj Konvente dhe nuk përfshihen në ato të përmbajtura në nenet e Marrëveshjes të saj ose në dispozita të tjera.

3. Dispozitat e Konventës (përfshi këtu dhe aneksin) nuk modifikojnë ose kërkojnë modifikimin e neneve të Marrëveshjes së Bankës dhe nuk urdhërojnë ose limitojnë ndonjë nga të drejtat, imunitetet, privilegjet apo përjashtimet e dhëna Bankës ose zyrtarëve të saj, si guvernatorëve, drejtorëve ekzekutivë, zëvendësve ose të punësuarëve sipas neneve të Marrëveshjes së Bankës apo të dispozitave të tjera.

Aneksi VIIg

ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETËSISË

Klauzolat standarde mbi Organizatën Botërore të Shëndetësisë (më poshtë e quajtur "Organizata") do të aplikohen sipas dispozitave të mëposhtme:

1. Neni 5, seksioni 25, paragrafi 1 dhe 2 (I) të nenit 7 do të aplikohen edhe ndaj Kryetarit të Këshillit të Organizatës, përveçse çdo heqje e imunitetit të Kryetarit, sipas seksionit 16 që do të vendoset nga Këshilli i Organizatës.

2. (i) Ekspertët (të ndryshëm nga zyrtarët e përcaktuar nga objekti i nenit 6) që i shërbejnë apo kryejnë misione për komitete të Organizatës do t'u njihen deri në masën që do të jetë e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave të tyre, duke përfshirë këtu dhe kohën e nevojshme për udhëtime të lidhura me shërbimet për komitetet apo misionet, privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

e) imunitetet personale ndaj arrestit ose ndalimit të bagazhit të tyre;

f) në lidhje me shprehjen e mendimeve të tyre gojarisht ose nëpërmjet akteve të shkruara në kryerjen e detyrave të tyre të zyrtare, kanë imunitet nga procese gjyqësore të të gjitha llojeve, imunitet i cili vlen edhe mbasi ose puna e tyre për Organizatën do të ketë përfunduar;

g) të njëjtat lehtësira në lidhje me limitime në shkëmbimin e parave dhe në lidhje me bagazhin e tyre personal, që u jepen zyrtarëve të qeverive të huaja në mision zyrtar të përkohshëm;

h) paprekshmëria e dokumenteve të lidhura me detyrën që zhvillojnë për llogari të Organizatës.

(ii) Në lidhje me paragrafin (d) të pikës 2(i) më sipër, principi i përmbajtur në fjalinë e fundit të seksionit 12 të kaluzolave standarde, do të aplikohet.

(iii) Privilegjet dhe imunitetet janë të garantuara për ekspertët e Organizatës, për interes të Organizatës dhe jo për përfitime personale të individëve. Organizata ka të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetet e ekspertëve në çdo rast kur besohet se imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë, në rastet kur një gjë e tillë nuk do të dëmtonte interesat e Organizatës.

3. Neni 5, seksioni 25, paragrafi 1 dhe 2(I) i nenit 7 do të aplikohen edhe ndaj përfaqësuesve të anëtarëve të lidhur që marrin pjesë në punën e Organizatës, në përputhje me nenet 8 dhe 47 të Kushtetutës.

Aneksi VIIIh

BASHKIMI UNIVERSAL I POSTAVE

Klauzolat standarde do të aplikohen pa modifikime.

^h Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm më 11 korrik 1949

Aneksi IXi

BASHKIMI NDËRKOMBËTAR I TELEKOMUNIKACIONIT

Klauzolat standarde do të aplikohen pa modifikime, përveç asaj që Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit nuk mund të kërkojë për veten e tij gëzimin e trajtimit të privilegjuar në lidhje "Lehtësitë në lidhje me komunikimin" të parashikuara në nenin 4, seksioni 11.

Aneksi Xj

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E REFUGJATËVE

Klauzolat standarde do të aplikohen pa modifikime.

Aneksi XIk

ORGANIZATA BOTËRORE E METEOROLOGJISË

Klauzolat standarde do të aplikohen pa modifikime.

Aneksi XII

ORGANIZATA NDËRQEVERITARE E KONSULENCËS DETARE

1. Privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet dhe lehtësirat e referuara në nenin 6, seksioni 21 i klauzolave standarde, do t'i akordohen Sekretarisë së Përgjithshme të Organizatës dhe Sekretarisë së Komitetit të Sigurisë Detare, me kusht që klauzolat e këtij paragrafi nuk do t'u kërkojnë anëtarëve në territorin e të cilëve Organizata ka zyrat e saj për të aplikuar nenin 6, seksioni 21 të klauzolave, i cili është shtetas i atij vendi.

2.(a) Ekspertët (të ndryshëm nga zyrtarët e përcaktuar nga objekti i nenin 6) që i shërbejnë ose kryejnë misionet për komitete të Organizatës do t'u njihen, deri në masën që do të jetë e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave të tyre, duke përfshirë këtu dhe kohën e nevojshme për udhëtime të lidhura me shërbimet e komiteteve apo misioneve, privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

(i) imunitet personal ndaj arrestit ose ndalimit të bagazhit të tyre;

(ii) në lidhje me shprehjen e mendimeve të tyre gojariht ose nëpërmjet akteve të shkruara në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, kanë imunitet procesual të të gjitha llojeve, imunitet i cili për ato raste do të zgjatet edhe mbasi ose puna e tyre për Organizatën do të ketë përfunduar;

(iii) të njëjtat lehtësira në lidhje me limitime në shkëmbimin e parave dhe në lidhje me bagazhin e tyre personal, u jepen zyrtarëve të qeverive të huaja, në mision zyrtar të përkohshëm;

(iv) paprekshmëria e dokumenteve të lidhura me detyrën që zhvillojnë për llogari të Organizatës;

(v) e drejta për të përdorur kodet dhe për të marrë dokumentacione dhe korrespondenca nga korrierët ose në pako të vulosura për komunikimin e tyre me Organizatën Ndërqeveritare të Konsulencës Bregdetare.

Në lidhje me paragrafin (a) (iv) dhe (v) të pikës 2 më sipër, principi i përmbajtur në fjalinë e fundit të seksionit 12 të klauzolave standarde, do të aplikohet.

(b) Privilegjet dhe imunitetet janë të garantuar për ekspertët e Organizatës, për interes të

ⁱ Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm më 16 janar 1949

^j Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm më 4 prill 1949

^k Tekst i dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm më 29 dhjetor 1949

Organizatës dhe jo për përfitime personale të individëve. Organizata ka të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetet e ekspertëve në çdo rast kur besohet se imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë, në rastet kur një gjë e tillë nuk do të dëmtojte interesat e Organizatës.

Aneksi XIII

KORPORATA NDËRKOMBËTARE E FINANCËS

Në këtë aplikim të Korporatës Ndërkombëtare të Financës (më tutje e quajtur "Korporata") Konventa (duke përfshirë edhe këtë aneks) do të operojë duke pasur si objekt klauzolat e mëposhtme:

1. Ajo çka më poshtë vijon, do t'i bashkëngjitet seksionit 4:

"Mund të ndërmerren veprime kundër Korporatës vetëm nga një gjyq i pajisur me juridiksion kompetent në territorin e atij shteti ku Korporata ka zyra, ka një agjent me qëllimin e pranimi të shërbimeve ose të vëzhgimit të progresit ose ka sigurime të garantuara. Asnjë veprim nuk do të ndërmerret nga anëtarët ose nga persona që varen prej tyre. Pronësia dhe asetet e Korporatës, kudo ku ajo ndodhet dhe kushdo që e drejton, do të kenë imunitet kundrejt të gjitha formave të konfiskimit deri në momentin e shpalljes së vendimit juridik përfundimtar kundër Korporatës".

2. Paragrafi (b) i seksionit 7 të klauzolave standarde do t'i aplikohet subjektit të Korporatës në nenin 3, paragrafi 5 i Statutit të Korporatës.

3. Korporata ka të drejtë që të heqë privilegje ose imunitete në bazë të nenin 6 të Statutit të saj bazuar në ato kushte që vendos ajo vetë.

4. Paragrafi 32 i klauzolave standarde do të aplikohet vetëm për ndryshimet që do të shfaqen nga interpretimi ose aplikimi i privilegjeve ose imunitetit që rrjedhin nga kjo Konventë dhe nuk përfshihen në ato ndryshime që mund të pretendohen të rrjedhin nga nenet e Marrëveshjes.

5. Klauzolat e Konventës (duke përfshirë edhe këtë aneks) nuk ndryshohen ose korrigjohen dhe as kërkojnë ndonjë rregullim të neneve të Marrëveshjes së Korporatës ose kufizim të të drejtave, imunitetit, privilegjeve ose përjashtimeve që bien mbi Korporatën ose një prej anëtarëve të saj, guvernatorët, drejtorët, zëvendësit, nëpunësit ose të punësuarit sipas neneve të Marrëveshjes së Korporatës apo çdo statuti, ligji ose standardi të një prej anëtarëve të Korporatës, ose nënndarjeje politike e ndonjë prej anëtarëve, ose tjetër arsye.

Aneksi XIV

SHOQATA NDËRKOMBËTARE E ZHVILLIMIT

Në aplikimin e saj në lidhje me Shoqatën Ndërkombëtare të Zhvillimit (më poshtë e quajtur "Shoqata") Konventa, përfshirë këtu edhe këtë aneks, do të veprojë në bazë të dispozitave të mëposhtme:

1. Sa më poshtë do të zëvendësojë seksionin 4:

"Veprimet kundër Shoqatës mund të ndërmerren vetëm para gjykatave kompetente të juridiksionit të territorit të një shteti anëtar në të cilin Shoqata ka një zyrë përfaqësimi, ka caktuar një agjent për pranimin e shërbimeve ose ka lëshuar dhe garantuar sigurime. Megjithatë, asnjë veprim nuk duhet të ndërmerret nga anëtarë ose persona që veprojnë për to ose ankesa të rrjedhura prej anëtarëve. Pasuria dhe asetet e Shoqatës, kudo që të ndodhen dhe nga cilido që i mban, duhet të mbrohen nga të gjitha format e zotërimit, bashkimit ose ekzekutimit deri në vendimin e gjykimit përfundimtar kundrejt Shoqatës".

2. Seksioni 32 i klauzolave standarde do të aplikohet vetëm për diferencat që lindin nga interpretimi ose aplikimi i privilegjeve dhe imuniteteve të cilat rrjedhin nga Shoqata, vetëm sipas kësaj Konvente dhe nuk përfshihen në ato të përmbajtura në statutin e saj ose në dispozita të tjera.

3. Dispozita e Konventës (përfshi këtu dhe aneksin) nuk modifikojnë ose kërkojnë

modifikimin e Statutit të Shoqatës dhe nuk pengojnë ose limitojnë ndonjë nga të drejtat, imunitetet, privilegjet ose përjashtimet e dhëna Shoqatës ose anëtarëve të saj, guvernatorëve, drejtorëve ekzekutivë, zëvendësve apo të punësuarëve sipas Statutit të Shoqatës, ndonjë ligji apo rregulloreje të anëtarëve të saj apo entiteteve politike të këtyre anëtarëve, e tjetër.

Aneksi XV

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE

Klauzolat standarde mbi Organizatën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelaktuale do të aplikohen sipas dispozitave të mëposhtme:

1. Privilegjet, imunitetet, përjashtimet dhe lehtësimet të përcaktuara në seksionin 21 të klauzolave standarde gjithashtu do t'u caktohen të gjithë zëvendësdrejtorëve të përgjithshëm të Organizatës.

2.(i) Ekspertët (të ndryshëm nga zyrtarët e përcaktuar nga objekti i nenit 6 që i shërbejnë apo kryejnë misione për komitetet e Organizatës do t'u njihen, deri në masën që do të jetë e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave të tyre, duke përfshirë këtu dhe kohën e nevojshme për udhëtime të lidhura me shërbimet e komiteteve ose misioneve, privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitet personal ndaj arrestit ose ndalimit të bagazhit të tyre;

b) në lidhje me shprehjen e mendimeve të tyre gojarisht ose nëpërmjet akteve të shkruara në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, kanë imunitet procesual të të gjitha llojeve, imunitet i cili për ato raste do të zgjatet edhe mbasi ose puna e tyre për Organizatën do të ketë përfunduar;

c) të njëjtat lehtësira në lidhje me limitime në shkëmbimin e parave dhe në lidhje me bagazhin e tyre personal, u jepen zyrtarëve të qeverive të huaja, në mision zyrtar të përkohshëm;

d) paprekshmëria e dokumenteve të lidhura me detyrën që zhvillojnë për llogari të Organizatës;

e) në lidhje me komunikimin me Organizatën, ka të drejtën e përdorjes së kodeve dhe të marrjes së korrespondencës me anë të korrierëve ose në pako të vulosura.

(ii) Në lidhje me paragrafin (d) të pikës 3(i) më sipër, principi i përmbajtur në fjalinë e fundit të seksionit 12 të klauzolave standarde, do të aplikohet.

(iii) Privilegjet dhe imunitetet janë të garantuara për ekspertët e Organizatës, për interes të Organizatës dhe jo për përfitime personale të individëve. Organizata ka të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetet e ekspertëve në çdo rast kur besohet se imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë, në rastet kur një gjë e tillë nuk do të dëmtojte interesat e Organizatës.

Aneksi VI

FONDI NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN BUIQËSOR

Klauzolat standarde mbi Fondin Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (me poshtë i quajtur "Fondi") do të aplikohen sipas dispozitave të mëposhtme.

1. Neni 5, seksioni 25, paragrafi 1 dhe 2(I) i nenit 7 do të aplikohen edhe ndaj Kryetarit të Këshillit të Fondit, përveçse çdo heqje e imunitetit të Kryetarit, sipas seksionit 16 do të vendoset nga Këshilli i Fondit.

2.(i) Ekspertët (të ndryshëm nga zyrtarët e përcaktuar nga objekti i nenit 6) që i shërbejnë ose kryejnë misione për komitete të Fondit do t'u njihen, deri në masën që do të jetë e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave të tyre, duke përfshirë këtu dhe kohën e nevojshme për udhëtime të lidhura me shërbimet e komiteteve ose misioneve, privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitet personal ndaj arrestit ose ndalimit të bagazhit të tyre;

b) në lidhje me shprehjen e mendimeve të tyre gojarisht ose nëpërmjet akteve të shkruara në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, kanë imunitet procesual të të gjitha llojeve, imunitet i cili për ato raste do të zgjatet edhe mbasi ose puna e tyre për Fondin do të ketë përfunduar;

c) të njëjtat lehtësira në lidhje me limitime në shkëmbimin e parave dhe në lidhje me bagazhin e tyre personal, që u jepen zyrtarëve të qeverive të huaja, në mision zyrtar të përkohshëm;

d) paprekshmëria e dokumenteve të lidhura me detyrën që zhvillojnë për llogari të Fondit.

(ii) Në lidhje me paragrafin (d) të pikës 2 (i) më sipër, principi i përmbajtur në fjalinë e fundit të seksionit 12 të klauzolave standarde, do të aplikohet.

(iii) Privilegjet dhe imunitetet janë të garantuara për ekspertët e Fondit, për interes të Fondit dhe jo për përfitime personale të individëve. Fondi ka të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetet e ekspertëve në çdo rast kur besohet se imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë, në rastet kur një gjë e tillë nuk do të dëmtonte interesat e Fondit.

3. Privilegjet, imunitetet, përjashtimet dhe lehtësimet e përcaktuara në seksionin 21 të klauzolave standarde do t'i njihen dhe Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Fondit.

D E K R E T
Nr.3926, datë 1.8.2003

PËR EMËRIM TË ANËTARIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në bazë të neneve 154 pika 1 dhe 93 të Kushtetutës dhe të nenit 22 pika 2 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

D E K R E T O J:

Neni 1

Zoti Klement Zguri emërohet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr.82, datë 28.7.2003

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN
NGA DETYRA TË ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT TË PUNËVE TË
JASHTME**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.3900, datë 23.7.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.3900, datë 23.7.2003 për shkarkimin e zotit Ilir Meta nga detyra e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.83, datë 28.7.2003

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E
ZONJËS ERMELINDA MEKSI NË DETYRËN E ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE
MINISTRIT TË INTEGRIMIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.3901, datë 23.7.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

- I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.3901, datë 23.7.2003 për emërimin e zonjës Ermelinda Mexi në detyrën e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Integrimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.84, datë 28.7.2003

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN
NGA DETYRA TË MINISTRIT TË INTEGRIMIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.3902, datë 23.7.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

- I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.3902, datë 23.7.2003 për shkarkimin e zotit Sokol Nako nga detyra e Ministrit të Integrimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.85, datë 28.7.2003

**PËR MOSMIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
EMËRIMIN E ZOTIT MARKO BELLO NË DETYRËN E MINISTRIT TË PUNËVE TË
JASHTME**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.3903, datë 23.7.2003 të Presidentit të Republikës,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

I. Mosmiratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr.3903, datë 23.7.2003 për emërimin e zotit Marko Bello në detyrën e Ministrit të Punëve të Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

**V E N D I M
Nr.86, datë 28.7.2003**

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 88 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8655, datë 31.7.2000, ligjin nr.8794, datë 10.5.2001 dhe ligjin nr.9016, datë 20.2.2003, si dhe nenin 7 të ligjit nr.9016, datë 20.2.2003,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

I. Të zgjedhë anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH:

1. Moikom Zeqo
2. Fatmir Braka
3. Petrit Malaj
4. Petrit Ymeri
5. Abaz Hado
6. Mirush Kabashi
7. Frano Kulli
8. Ilir Yzeiri
9. Agron Bala
10. Mark Marku
11. Gazmend Shpuza
12. Shezai Rrokaj
13. Vojsava Nelo
14. Kiço Blushi
15. Andi Bushati

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pellumbi

V E N D I M
Nr.87, datë 31.7.2003

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 22 pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Zoti Dodë Prenga zgjidhet në detyrën e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vend të zotit Gaspër Kokaj, të cilit i ka mbaruar mandati.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pellumbi

U D H Ë Z I M
Nr.2, datë 25.7.2003

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 11.7.2003 TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE "MBI PROCEDURAT E RISHIKIMIT TË LISTAVE PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE 2003"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e tij të datës 25.7.2003, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi Kryetar
Tomor Malaj Anëtar
Pandeli Varfi Anëtar
Igli Toska Anëtar
Maksim Shimani Anëtar

Në mbështetje të nenit 29/1,6, nenit 31/1, nenit 44/2 dhe të nenit 58 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

U D H Ë Z O N:

Në udhëzimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.1, datë 11.7.2003 "Mbi procedurat e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2003", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën I. (i) fjalja e fundit bëhet: "Procesi i rishikimit të listave paraprake fillon me shpalljen e tyre dhe përfundon tri javë para datës së zgjedhjeve.
2. Në pikën I.(iii) paragrafi i tretë bëhet: "Vendimi merret kur për të votojnë jo më pak se 5 anëtarë me të drejtë vote të KZQV-së".
3. Në pikat III.a, III.b dhe III.c fjalët "zgjedhësi ose një parti politike" zëvendësohen me fjalët "zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucione të tjera të interesuara".
4. Pika III.ç bëhet si më poshtë:

"ç. Zgjedhësi ka ndryshuar vendbanimin ose vendqëndrimin e tij dhe dëshiron të regjistrohet në listën e vendbanimit ose vendqëndrimit të ri.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

(i) Kur kërkesa paraqitet nga vetë zgjedhësi:

1. Kërkesë me shkrim për t'u shtuar në listën e zgjedhësve të asaj njësie.

2. Një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;

- letërnjoftim;

- pasaportë;

- kartë zgjedhësi;

- dhe kur ka një nga këto tre të fundit dhe fotokopjen e saj.

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

3. Një dokument pronësie për të provuar vendbanimin e deklaruar. Kur zgjedhësi është me vendbanim në atë njësi, mjafton një certifikatë personale e lëshuar nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie. Kur zgjedhësi është me vendqëndrim në atë njësi, mjafton një vërtetim nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie që është i regjistruar në regjistrimin e shtetasve me vendqëndrim.

(ii) Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar:

1. Kërkesë me shkrim për të shtuar personin/at përkatës në listën e zgjedhësve të asaj njësie;

2. Kërkesë personale e zgjedhësit e noterizuar, ku të jepet adresa e saktë dhe qendra e votimit që pretendon të jetë;

3. Një dokument pronësie për të provuar vendbanimin e deklaruar. Kur zgjedhësi është me vendbanim në atë njësi, mjafton një certifikatë personale e lëshuar nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie. Kur zgjedhësi është me vendqëndrim në atë njësi, mjafton një vërtetim nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie që është i regjistruar në regjistrin e shtetasve me vendqëndrim.

5. Pika III.d bëhet si më poshtë:

"d. Zgjedhësi nuk i ka të sakta të dhënat vetjake në listën e zgjedhësve.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

(i) Kur kërkesa paraqitet nga vetë zgjedhësi:

1. Kërkesë me shkrim për të saktësuar të dhënat vetjake në listën e zgjedhësve të asaj njësie.

2. Një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;

- letërnjoftim;

- pasaportë;

- kartë zgjedhësi;

- dhe kur ka një nga këto tre të fundit dhe fotokopjen e saj.

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin, firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

(ii) Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar:

1. Kërkesë me shkrim për të saktësuar të dhënat e zgjedhësit/ve në listën e zgjedhësve të asaj njësie.

2. Kërkesë personale e zgjedhësit e shoqëruar me certifikatë personale të tij.

6. Pas pikës III.d shtohen pikat dh) dhe e) me këtë përmbajtje:

dh) Zgjedhësi është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

(i) Kur kërkesa paraqitet nga vetë zgjedhësi, ai duhet të paraqesë përpara KZQV-së, një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;
- letërnjoftim;
- pasaportë;
- kartë zgjedhësi;

- dhe kur ka një nga këto tre të fundit dhe fotokopjen e saj

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

(ii) Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar:

- Kërkesë me shkrim ku të jetë/në shënuar zgjedhësi/sit që pretendohet se nuk është/janë në qendrën e duhur të votimit.

- Kërkesë personale e zgjedhësit ku të jepet adresa e saktë dhe qendra e votimit që pretendon të jetë, e shoqëruar me certifikatë personale të tij.

e) Zgjedhësi nuk është në listën paraprake të qendrës së votimit të vendbanimit të tij.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

(i) Kur kërkesa paraqitet nga vetë zgjedhësi:

1. kërkesë me shkrim për t'u shtuar në listën e zgjedhësve të asaj njësie.

2. një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;
- letërnjoftim;
- pasaportë;
- kartë zgjedhësi;

- dhe kur ka një nga këto tre të fundit dhe fotokopjen e saj.

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

3. Një dokument pronësie për të provuar vendbanimin e deklaruar. Kur zgjedhësi është me vendbanim në atë njësi, mjafton një certifikatë personale e lëshuar nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie. Kur zgjedhësi është me vendqëndrim në atë njësi, mjafton një vërtetim nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie që është i regjistruar në regjistrin e shtesave me vendqëndrim.

(ii) Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar:

- kërkesë me shkrim ku të jetë në shënuar zgjedhësi/sit që pretendohet se nuk është/janë në listën paraprake të asaj njësie, megjithëse është/janë me vendbanim aty, duke vënë dhe adresën përkatëse.

3. Shqyrtimi i kërkesës dhe marrja e vendimit.

(i) Në rastet kur kërkesa është bërë nga zgjedhësi dhe KZQV-ja ka provat e mjaftueshme, merr vendim sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin I, pika (iii) të udhëzimit të KQZ-së nr.1, datë 11.7.2003.

(ii) Në rastet kur kërkesa është paraqitur nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar, KZQV-ja i kërkon zyrës së gjendjes civile së komunës ose bashkisë, jo më vonë se 24 orë nga bërja e kërkesës, t'i deklarojë nëse personi/at/i/e kërkuar është/janë me vendbanim në atë njësi. Zyra e gjendjes civile duhet t'i kthejë përgjigje KZQV-së jo më vonë se 2 ditë nga paraqitja e kërkesës nga KZQV-ja. Nëse personi nuk është me vendbanim, KZQV-ja rrëzon kërkesën. Nëse personi është me vendbanim, KZQV-ja cakton me vendim, jo më vonë se 24 orë nga marrja e përgjigjes nga zyra e gjendjes civile, një ose sipas rastit disa grupe verifikimi. Grupi i verifikimit përbëhet nga dy persona të propozuar përkatësisht nga kryetari e zëvendëskryetari i KZQV-së.

1. Në rast se grupi i verifikimit gjen zgjedhësin, ai duhet t'i marrë atij një deklaratë nëse dëshiron të votojë në atë njësi zgjedhore. Deklarata është sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja dhe kundërfirmohet dhe nga anëtarët e grupit të verifikimit.

- Nëse zgjedhësi deklaron se nuk dëshiron të votojë në këtë njësi, KZQV-ja përkatëse merr vendim për rrëzimin e kërkesës.

- Nëse zgjedhësi deklaron se dëshiron të votojë në këtë njësi, KZQV-ja i kërkon atij të paraqesë dokumentet sipas pikës e)2(i) dhe merr vendim sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin I, pika (iii) të udhëzimit të KQZ-së nr.1, datë 11.7.2003.

2. Në rastin kur grupi i verifikimit, brenda 4 ditësh nga paraqitja e kërkesës, nuk e gjen zgjedhësin në adresën e dhënë, merr vendim sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin I, pika (iii) të udhëzimit të KQZ-së nr.1, datë 11.7.2003, e shpall atë duke njoftuar njëkohësisht dhe kërkuuesin."

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

RREGULLORE **PËR VEPRIMTARINË VALUTORE**

KREU I **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1 **Baza ligjore dhe qëllimi**

1.1 Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe ligji nr.8365, datë 02.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

1.2 Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e rregullave lidhur me veprimet në llogarinë kapitale dhe në llogarinë korente midis rezidentëve dhe jorezidentëve, nga brenda-jashtë dhe nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2 **Përcaktime**

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a- Rezident:

- individin, në rast se është shtetas shqiptar dhe ka një vendbanim të qëndrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kuptimit të nenit 12 të Kodit Civil;

- diplomatin dhe punonjësën shqiptar të caktuar me punë nga Shteti shqiptar, si dhe familjarët e tij, në ambasada, në konsullata ose në organizma ndërkombëtarë jashtë shtetit, jo të përfshira në aktivitet ekonomik ose tregtar;

- individin, që, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë për më tepër se 183 ditë brenda një viti kalendarik;

- personin fizik dhe juridik që ka selinë e vet të përhershme në Republikën e Shqipërisë;

- shtetasin e huaj, i cili disponon lejeqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, lëshuar sipas ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt";

-individin, që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për arsye pune, studimi, trajtimi mjekësor ose për arsye të tjera të ngjashme, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe që është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

b-Seli e përhershme:

Selinë e përcaktuar në aktin e themelimit ose të krijimit të personit juridik, në përputhje me ligjin përkatës. Konsiderohet seli e përhershme edhe selia e degës, e filialit ose e zyrës së përfaqësisë së personit juridik.

c- Jorezident:

Të gjithë personat (individë, person fizik apo juridik) që nuk përfshihen në përcaktimin e termit rezident të shprehur në këtë rregullore.

d- Mjet pagese në valutë:

Çdo instrument monetar në formën e kartëmonedhës ose të monedhës metalike, të çekut, të kambialit, të premtimpagesës, të letërkreditit dhe të urdhrave ose të instrumenteve të tjera të pagesës në valutë dhe që paguhen në valutë.

e-Valutë:

Mjetet financiare në formën e kartëmonedhave, të monedhave metalike të huaja, të cilat kanë

kurs ligjor dhe mjetet financiare në formën e llogarive dhe të depozitave në monedhë të huaj, në institucionet financiare të vendit dhe të huaja, të cilat mund të transferohen me anë të mjeteve të pagesës, për pagesat në valutë.

f- Monedhë e konvertueshme:

Monedhën lirisht të tregtueshme me një monedhë tjetër në tregun ndërkombëtar.

g- Kurs këmbimi:

Çmimin relativ të një monedhe të shprehur në njësi të një monedhe tjetër, referuar një date të caktuar.

h- Veprim këmbimi valutor:

Këmbimin, blerjen ose shitjen e valutave në cash dhe nëpërmjet llogarisë personale ose të të tretëve. Shlyerja e kredisë financiare në monedhë të ndryshme nga ajo me të cilën është akorduar ose pranuar, vetëm nëse kjo nuk ka rezultuar nga marrëveshja me shkrim e palëve.

i- Tregu i këmbimeve valutore:

Tregun ku kryhen veprimet e këmbimit valutor.

j- Ar dhe metale të çmuara:

Arin dhe metalet e çmuara të standardizuara.

Arin dhe metalet e çmuara të pastandardizuara.

k- Standardizim i arit dhe i metaleve të çmuara:

Formën unike të arit ose të metaleve të çmuara, të pranuar për t'u këmbyer në tregun ndërkombëtar të arit.

l- Metale të çmuara:

Platini.

ll- Licencë për të kryer veprimtari të këmbimit valutor:

Aktin administrativ të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, që jep të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së këmbimeve valutore.

m- Kontratë:

Veprimin juridik me anë të të cilit një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike. Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi.

n- Detyrim monetar:

Detyrimin për të paguar një shumë parash, që shlyhet me vleftën e vet nominale, përveç kur rezulton ndryshe nga ligji ose nga kontrata.

o- Subjektet e licencuara:

Të gjitha subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarive të përcaktuara në këtë rregullore.

p- Operatorët e tregut të këmbimeve valutore:

Bankën e Shqipërisë dhe subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë.

KREU II VEPRIMET VALUTORE

Neni 3

Llojet e veprimeve valutore

3.1. Veprimet valutore kryhen nëpërmjet transaksioneve që përfshihen në:

a. llogarinë kapitale;

b. llogarinë korente.

3.2. Rezidentët dhe jorezidentët mund të këmbëjnë valutën në monedhën kombëtare dhe anasjelltas, si dhe një lloj valute në një lloj tjetër valute nëpërmjet operatorëve të tregut të këmbimeve valutore.

Neni 4

Veprimet në llogarinë kapitale

4.1. Veprimet në llogarinë kapitale janë të gjitha transaksionet që kryhen ndërmjet rezidentëve

dhe jorezidentëve dhe regjistrohen në llogarinë e kapitalit të bilancit të pagesave. Këto janë:

- a) investime direkte;
- b) transaksione në letra me vlerë;
- c) transaksione të kreditit;
- d) transaksione të depozitave;
- e) transaksione të sigurimit dhe të risigurimit, kur lejohet nga legjislacioni shqiptar.

4.1.1. Investime direkte

Në investimet direkte përfshihen:

- a) krijimi ose zgjerimi i një shoqërie, që zotërohet plotësisht nga investuesi, krijimi i një filiali ose dege, ose blerja e një shoqërie ekzistuese, që kalon në pronësi të plotë të investuesit;
- b) pjesëmarrja në një shoqëri të re ose ekzistuese, nëse investuesi zotëron ose ka në pronësi mbi 10 për qind pjesëmarrje në kapitalin bazë të shoqërisë ose mbi 10 për qind të të drejtave të votës;
- c) kredia financiare me maturim 5 vjet ose më shumë, me qëllim vendosjen e lidhjeve ekonomike afatgjata, sipas gërmave a dhe b të këtij paragrafi;
- d) përdorimi i fitimit nga një investim ekzistues në të njëjtin investim (riinvestimi i fitimit).
- e) investimi në aktive të qëndrueshme të trupëzuara për qëllime tregtare ose banimi.

4.1.2. Transaksione në letra me vlerë

Për të plotësuar kërkesat e kësaj rregulloreje:

4.1.2.1. Letrat me vlerë janë të gjitha instrumentet financiare të pronësisë dhe instrumentet financiare të normave të interesit.

4.1.2.2. Transaksionet në letra me vlerë janë të gjitha transaksionet e emetimit, e investimit, e listimit të letrave me vlerë, që tregojnë fillimin e tregtimit të letrave me vlerë të subjekteve të huaja në Republikën e Shqipërisë ose të letrave me vlerë të subjekteve vendase jashtë vendit. Të tilla të konsiderohen :

- a) emetimi dhe listimi i letrave me vlerë të subjekteve vendase jashtë Republikës së Shqipërisë;
- b) investimi nga rezidentët në letra me vlerë jashtë Republikës së Shqipërisë;
- c) emetimi dhe listimi i letrave me vlerë të subjekteve të huaja në Republikën e Shqipërisë;
- d) investimi nga jorezidentët në letra me vlerë të subjekteve vendase në Republikën e Shqipërisë.

4.1.3. Transaksione të kreditit

4.1.3. Transaksionet e kreditit konsistojnë në përfundimin e një kontrate kredie ose të një kontrate huaje, me objekt paranë.

Kontratat e kredisë ose të huasë mund të jenë në formën e:

- a) kredive tregtare që përfaqësojnë kreditë që lidhen me tregtinë ndërkombëtare dhe me ofrimin e shërbimeve ndërkombëtare, ku njëra prej palëve është rezidente;
- b) huave familjare që përfaqësojnë huatë ndërmjet personave, që kanë lidhje trashëgimie ligjore, ku njëra prej palëve është jorezidente;
- c) kredive financiare, që përfaqësojnë kreditë, përveç atyre të përcaktuara tek paragrafi 4.1.1.c. Kreditë financiare përfshijnë edhe kreditë për blerjen e pasurive të patundshme dhe qiranë financiare.

4.1.4. Transaksione të depozitave

Transaksionet e depozitave janë transaksionet e kryera në bazën e një kontrate, që përfshin hapjen e një llogarie rrjedhëse ose të një llogarie depozite nga një bankë rezidente në një bankë jorezidente ose anasjelltas.

4.1.5. Transaksione të sigurimit

Transaksionet e sigurimit janë transaksionet e kryera mbi bazën e një kontrate sigurimi ndërmjet një jorezidenti dhe një rezidenti dhe anasjelltas, që rezultojnë në:

- a- transferimin e kapitalit nga një jorezident (siguruesi) tek një rezident (përfituesi);
- b- transferimin e kapitalit nga një rezident (siguruesi) tek një jorezident (përfituesi), sipas përcaktimit të bërë nga legjislacioni shqiptar.

4.2. Në kuptim të këtij neni, veprime në llogarinë kapitale janë gjithashtu, transaksionet e tjetërsimit të një investimi mbi baza ligjore.

Neni 5

Veprimet në llogarinë korente

5.1. Veprime në llogari korente janë të gjitha transaksionet që kryhen ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve dhe regjistrohen në llogarinë korente të bilancit të pagesave.

5.2. Pagesat dhe transferimet për transaksionet në llogarinë korente përfshijnë:

a) të gjitha pagesat, që rrjedhin nga tregtia ndërkombëtare, veçanërisht:

- pagesat për blerje me qëllim rishitjeje dhe përgjithësisht çdo pagesë për veprim shkëmbimi të lidhur me një veprim tjetër shkëmbimi;

- çdo pagesë për kryerjen e shërbimeve në fushën industriale, të ndërtimit, të shfrytëzimit të minierave, të transportit, të sigurimit, të magazinimit, të shfaqjeve publike, të reklamës, të konsulencës, të botimit dhe të shtypshkrimit joartizanal;

- pagesat për çdo operacion bankar dhe këmbimi;

- pagesat për të gjitha operacionet e ndërmjetësimit;

b) pagesat e kryegjësë dhe të interesave të kredisë, që u ka ardhur afati i shlyerjes;

c) transferimet e njëanshme të kapitalit, të cilat përfshijnë:

c.1. Transfertat personale të aktiveve, të cilat janë transfertat e aktiveve nga/në Republikën e Shqipërisë nga titulli i një kredie familjare, dhurate, prike, trashëgimie, shlyerja e një borxhi nga një emigrant në vendin e tij të lindjes, transferimi i aktiveve të një emigranti në një vend të huaj për zbatimin e një vendimi gjykate, të ardhurat nga lojrat e fatit dhe kursimet e personave të punësuar në Republikën e Shqipërisë, të cilët nuk janë rezidentë.

c.2. Transfertat fizike të aktiveve, të cilat janë transportimi në cash i monedhës vendase ose të huaj dhe i letrave me vlerë nga dhe në Republikën e Shqipërisë (sipas udhëzimit nr.1 të kësaj rregulloreje).

Subjektet e licencuara kryejnë transferime të njëanshme të kapitalit për llogari të rezidentëve dhe të jorezidentëve, pas plotësimit të dokumentacionit, që vërteton qëllimin e veprimit, të përcaktuar nga vetë subjekti;

d) transfertat e përcaktuara në udhëzimin 2, pjesë e kësaj rregulloreje.

KREU III

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Neni 6

Kriteret për transferimin e kapitalit

6.1. Transferimi i kapitalit nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentët dhe jorezidentët kryhet pa kufizim.

6.2. Transferimi i kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të vetë subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, bëhet me vendim të organeve përkatëse të tyre.

6.3. Subjektet e licencuara kryejnë transferimin e kapitalit nga brenda-jashtë Republikës së Shqipërisë, për llogari të klientëve të tyre pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar si më poshtë, si dhe dokumenteve të tjera shtesë që subjektet mund ta shikojnë të arsyeshme:

6.3.1. Për personat fizikë dhe juridikë:

a) kërkesa ku shpjegohen arsyet për të cilat kërkohet transferimi i kapitalit, burimi i krijimit të këtij kapitali, shuma e kapitalit, që kërkohet të transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet;

b) dokumenti i subjektit të huaj, që shpjegon këtë transferim (në rast se ka të tilla);

c) vendimi i organit vendimmarrës të subjektit për kryerjen e transferimit të kapitalit;

d) vendimi i regjistrimit në gjykatë;

e) vërtetim nga zyra e tatim-taksave se ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj shtetit.

6.3.2. Për individët:

a) kërkesa ku shpjegohen arsyet, për të cilat kërkohet transferimi i kapitalit, shuma e kapitalit që kërkohet të transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet,

b) deklaratë mbi burimin e krijimit të kapitali që kërkohet të transferohet.

6.4. Për raste të veçanta të parashikuara në këtë paragraf, transferimi i kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga subjektet e licencuara kryhet pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar për secilin rast:

a) Kur kapitali i hyrë në Shqipëri, i transferuar nëpërmjet një banke të huaj, për qëllime investimi, nuk është përdorur, transferimi kryhet me paraqitjen në bankë të vendimit të organit vendimmarrës të subjektit për ndërprerjen e investimit dhe me kusht që banka të vërtetojë mospërdorimin e shumës së kapitalit të derdhur për këtë qëllim;

b) Transferimi i kapitalit brenda shumës së kapitalit të regjistruar në Shqipëri dhe të ardhurave të siguruara nga investimi i kësaj shume, të vërtetuara me dokumentacionin përkatës (ligji nr.7764, datë 2.11.1993 "Për investimet e huaja"). Si dokumentacion shoqërues shtesë në këtë rast, shërben vërtetimi i lëshuar nga organet tatimore, i cili tregon shumën e kapitalit të investuar, fitimin e realizuar (pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet tatimore), si dhe një vendim i organit vendimmarrës të subjektit, ku theksohet ndarja dhe përdorimi i fitimit;

c) Transaksionet e depozitave ndërbankare, që kryhen në bazë të një kontrate, që përfshin veprimet në një llogari rrjedhëse ose në një llogari depozite ndërmjet një banke rezidente të licencuar dhe një banke jorezidente ose anasjelltas, ndërmjet një banke rezidente dhe një institucioni financiar jorezident.

d) Kreditë tregtare me afat maturimi deri në një vit, që lidhen direkt me tregtinë ndërkombëtare dhe me ofrimin e shërbimeve në këmbimet ndërkombëtare. Si dokumentacion shoqërues është vetë kontrata e kredisë;

e) Transferim i valutës, që buron nga depozitat e një jorezidenti, si dhe të ardhurat që rrjedhin prej tyre. Në raste të tilla, si dokumentacion shoqërues shërben dokumenti i bankës, që vërteton shumën që transferohet.

f) Transferim i valutës prej një emigranti shqiptar në momentin e largimit nga Republika e Shqipërisë. Në këtë rast, i interesuari paraqet në bankë një nga dokumentet e mëposhtme:

- dokumentin e nënshtetësisë së huaj apo lejen e qëndrimit të tij, të lëshuar nga organet përkatëse të shtetit të huaj ku ai qëndron;

- një dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit të huaj, që vërteton rezidencën e tij në atë shtet;

- dokumentin ose vizën, lëshuar nga autoritetet përfaqësuese të shtetit të huaj, i cili vërteton qëndrimin e përhershëm të tij në atë shtet.

g) Transferimi i të ardhurave të siguruara nga pasuria apo nga investimet e një emigranti shqiptar që jeton jashtë Shqipërisë. I interesuari paraqet në bankë një nga dokumentet e parashikuara në pikën f, si dhe një deklaratë personale për (ose kur është e mundur dokumentin që vërteton) burimin e të ardhurave që kërkohet të transferohen.

h) Transferim kapitali brenda shumës së kapitalit dhe të ardhurave që rezultojnë nga shitjet, nga likuidimi i pjesshëm ose nga likuidimi i plotë i një investimi. Si dokumentacion shoqërues shtesë, në këtë rast, do të shërbejë akti i shitjes ose akti i likuidimit nga gjykata dhe vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve tatimore.

Neni 7

Transaksionet të pagesave me jashtë

7.1. Transaksionet e pagesave me jashtë kryhen prej subjekteve të licencuara.

7.2. Çdo individ, ka të drejtë të transferojë lirisht nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ekuivalenten në çdo monedhë tjetër të shumës deri në 3.5 milionë lekë, sipas kursit të ditës dhe brenda afatit kohor të një viti kalendarik. Transferimi, deri në këtë kufi, mund të kryhet njëherazi ose pjesërisht. Për të kryer transferimin, klienti duhet të plotësojë:

a) kërkesën për transferimin e shumës, duke specifikuar qëllimin e veprimit;

b) deklaratën personale që ka respektuar kufirin e përcaktuar në paragrafin 7.2 të kësaj rregulloreje.

7.3. Për transfertat tregtare dhe jotregtare në valutë, dokumentacioni që duhet të plotësohet është përcaktuar në udhëzimet 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje.

7.4. Për transaksionet e pagesave me jashtë në Republikën e Shqipërisë, zbatohen rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të njohura, marrëveshjet ndërbankare dypalëshe e shumëpalëshe, si dhe

zakoni bankar.

KREU IV INVESTIMET DHE LLOGARITË E JOREZIDENTËVE

Neni 8

Investimet në letrat me vlerë

Jorezidentët mund të blejnë ose të shesin letra me vlerë në Republikën e Shqipërisë dhe të ushtrojnë të drejtat, që rrjedhin prej kësaj vetëm nëpërmjet një banke ose institucioni financiar të autorizuar, ruajtës, sipas një kontrate të përfunduar në lidhje me shërbime ruajtjeje, që lidhet me letrat me vlerë.

Neni 9

Llogaritë e jorezidentëve

Jorezidentët mund të hapin pa kufizim llogari në monedhë të huaj ose në monedhën vendase, në një bankë ose degë të bankës së huaj, të licencuar nga Banka e Shqipërisë.

KREU V DETYRIMI PËR RAPORTIM

Neni 10

Operatorët e tregut të këmbimeve valutore, në zbatim të nenit 65 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë sipas udhëzimit "Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore" miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

KREU VI LËVIZJET FIZIKE TË VALUTËS, TË ARIT DHE TË METALEVE TË ÇMUARA

Neni 11

Lëvizjet fizike të valutës në pikat doganore

11.1. Rezidentët lejohet të nxjerrin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë shumën e valutës në cash dhe në çeqe udhëtarësh deri në kundërvlerën e 3.5 milionë lekëve. Për shumat mbi 1 milionë lekë çdo rezident është i detyruar të deklarojë lidhur me origjinën e parave që kërkon të transferojë.

11.2. Jorezidentët dhe qytetarët e huaj (rezidentët) që vizitojnë përkohësisht Republikën e Shqipërisë, mund të nxjerrin jashtë saj valutë në cash dhe në çeqe udhëtarësh deri në shumën e deklaruar kur kanë hyrë, e cila justifikohet me paraqitjen e deklaratës të plotësuar në hyrje dhe me dokumentet përkatëse në qoftë se ka shtesa.

11.3. Tregtarët, si persona fizikë ose juridikë shqiptarë, lejohet të nxjerrin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për çdo kalim, në pikat doganore, shumat në cash ose në çeqe udhëtarësh, deri në kundërvlerën e 3.5 milionë lekëve në çdo monedhë të huaj. Krahas deklaramit të shumës, tregtari duhet t'i paraqesë autoriteteve doganore certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.

Neni 12

Lëvizjet fizike të arit dhe të metaleve të çmuara në pikat doganore

12.1. Rezidentët dhe jorezidentët kanë të drejtë të transferojnë nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, arin dhe metalet e çmuara të standardizuara vetëm nëpërmjet subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, sipas përcaktimit të bërë në aneksin e licencës së akorduar nga Banka e Shqipërisë. Dokumentacioni që duhet të plotësohet përcaktohet nga vetë subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë, i cili kryen shërbimin.

12.2. Rezidentët dhe jorezidentët kanë të drejtë të transferojnë nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, arin dhe metalet e çmuara të pastandardizuara nga pikat doganore, vetëm pas plotësimit të deklaratës lidhur me burim(origjinën) e tij, qëllimin e transferimit, sasinë që kërkohet të transferohet, kthimin ose jo të metaleve të çmuara dhe për formën e kthimit.

Ky dokumentacion nuk paraqitet për bizhuteritë e përdorimit personal.

12.3. Bankat dhe degët e bankave të huaja, kanë të drejtë të kryejnë transaksione me arin dhe me metalet e çmuara vetëm pas licencimit të tyre nga Banka e Shqipërisë për këtë aktivitet. Transaksionet e hyrjes dhe të daljes së arit dhe të metaleve të çmuara trajtohen dhe realizohen njëjloj si dhe për valutat.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13

Paraqitja e dokumentacionit dhe detyrimet e subjekteve

13.1. Dokumentacioni, i kërkuar në këtë rregullore dhe në udhëzimet pjesë përbërëse të saj, paraqitet tek subjekti i licencuar në origjinal dhe vërtetimi i tij bëhet nga vetë subjekti i licencuar, i cili do të bëjë fotokopjen nga origjinali, duke vënë një vulë të posaçme (datore) mbi secilën nga fletët e fotokopjuara, që i jep vlefshmërinë e duhur dokumentit. Përveç sa më sipër, për aktin e zhdoganimit vulozet edhe origjinali.

13.2. Rezidentët dhe jorezidentët, që kryejnë një operacion valutor në tregun e këmbimeve valutore, përgjigjen për vërtetësinë e të gjithë dokumentacionit të paraqitur.

13.3. Subjektet e licencuara janë të detyruara të plotësojnë dhe të ruajnë të gjithë dokumentacionin e parashikuar në këtë rregullore dhe në udhëzimet pjesë përbërëse të saj.

13.4. Banka e Shqipërisë vendos masa ndëshkimore e penalitete, sipas kreut VI të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", kur subjektet e licencuara nuk veprojnë në përputhje me këtë rregullore dhe me udhëzimet pjesë përbërëse të saj.

Neni 14

14.1. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë :

- Udhëzimi nr.1 "Mbi transfertat për veprimet tregtare në valutë".

- Udhëzimi nr.2 "Mbi transfertat e veprimeve jotregtare në valutë".

14.2. Kjo rregullore u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.64, datë 30.7.2003 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

14.3. Rregullorja "Mbi veprimtarinë valutore" dhe udhëzimet e saj, të miratuara me vendimin nr.12, datë 21.2.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohen.

**KRYETARI
Shkëlqim Cani**

UDHËZIMI 1 MBI TRANSFERTAT PËR VEPRIMET TREGTARE NË VALUTË

1. Transfertat për veprimet tregtare për mallrat

Transfertat për veprimet tregtare për mallrat, nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga i njëjti subjekt gjatë një dite pune nga personat fizikë, juridikë, të kryhen kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

1.1. Kur pagesa kryhet paradhënie ose para mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë:

a) kërkesa për kryerjen e veprimit, ku jepet përshkrimi i natyrës dhe i qëllimit për të cilin kryhet, nënshkruar nga vetë kërkuuesi. Po në këtë kërkesë, subjekti të deklarojë se dokumentacioni i

paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera;

b) fatura pro-forma dhe kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës;

c) akti i zhdoganimit të mallit :

c.1. Në rastet e pagesës së pjesshme të shumës totale, në përputhje me kushtet e kontratës, afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Me kalimin e këtij afati nuk do të kryhet pagesa e rradhës për këtë mall deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit të mallit të paguar.

c.2. Në rastet e transfertave të pjesshme, kur operohet me magazinë doganore, sipas Kodit Doganor, pagesa e rradhës do të kryhet vetëm pas paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit, për atë pjesë të zhdoganuar të tij, që ka qenë nën regjimin e magazinimit doganor.

Afati maksimal i paraqitjes së këtij dokumenti është 12 muaj nga data e importimit. Pranohet një shtyrje, për 12 muaj të tjerë, në rast se një gjë e tillë është pranuar nga organet që e kanë në kompetencë sipas Kodit Doganor. Pas këtij afati, pagesa e rradhës nuk do të kryhet deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit.

c.3. Në rastin e likuidimit të menjëhershëm të shumës së kontratës afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Përjashtim bëjnë rastet kur afati i lëvrimit të mallit ose i kryerjes së shërbimit është përcaktuar ndryshe në kontratë, por jo më shumë se 12 muaj.

1.2. Kur pagesa kryhet pas mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë:

a) kërkesa si në pikën 1.1., gërma a;

b) akti i zhdoganimit të mallit.

1.3. Për transfertat në tregun e mallrave, që kalojnë transit në Republikën e Shqipërisë, zbatohen kërkesat e ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

1.4. Në rastin kur blerja dhe shitja e mallit realizohet nëpërmjet dy shteteve të ndryshme nga Shqipëria dhe malli nuk hyn në Shqipëri, por vetëm pagesa e mallit realizohet nëpërmjet Shqipërisë, transferata kryhet duke u bazuar në dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1.1 të këtij udhëzimi. Kërkesa e pikës 1.1 gërma c, plotësohet me aktin e zhdoganimit të mallit të njërit prej këtyre shteteve.

2. Transfertat për veprimet tregtare për shërbimet

2.1. Për veprimet e transfertave tregtare, në çdo rast shërbimi, sipas specifikimeve të bëra në nenin 5.2 të rregullores "Për veprimtarinë valutore", subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm, sipas specifikave të secilit klient:

a) kërkesa sipas pikës 1.1., gërma a;

b) fatura përkatëse e subjektit ose një dokument, i cili vërteton qëllimin për të cilin kërkohet kryerja e transfertës;

c) kontrata ose marrëveshja përkatëse.

UDHËZIMI 2

MBI TRANSFERTAT E VEPRIMEVE JOTREGTARE NË VALUTË

1. Në transfertat e veprimeve jotregtare përfshihen:

a) studime dhe kontrolle të kryera nga shoqëri të huaja;

b) kurse, konferenca dhe konkurse jashtë vendit;

c) studime, specializime dhe trajnime jashtë vendit;

d) shërbime shëndetësore dhe mjeksore jashtë vendit;

e) ekspertiza teknike, komisione për planifikimin dhe kontrollin, që kanë lidhje me ndërtimet, me zbatimin e projekteve dhe me planifikime të tjera;

f) përpunimi elektronik i të dhënave;

g) planifikimi teknik dhe administrativ;

h) qira të filmave dhe të programeve televizive dhe pagesat për të drejtën e autorit;

i) shpenzime korente të degëve dhe të zyrave të përfaqësimit të shoqërive dhe të bankave, si qiratë, shpenzimet operative etj., misionet diplomatike shqiptare dhe të huaja, misionet tregtare, forcat paqeruajtëse, programet e këmbimit kulturor dhe të nxitjes së turizmit;

j) patentat dhe të drejtat e autorit, pagat dhe rogat e zakonshme, shpenzimet e natyrës joperiodike të jorezidentëve;

- k) qira financiare të pajisjeve operative dhe të makinerive;
 - l) qira financiare afatshkurtra (deri 1 vit);
 - m) shlyerja e huave;
 - n) pensione;
 - o) pagesa për anëtarësi;
 - p) asistencë e dërguar organizatave fetare;
 - q) transaksione me organizatat ndërkombëtare;
 - r) qira të ndryshme në favor të emigrantëve dhe të jorezidentëve;
 - s) shpenzime jetese familjare, në përputhje me nenin 5, pikat b dhe c.
2. Në transfertat e veprimeve jotregtare përfshihen edhe të gjitha transfertat e tjera, të ngjashme me ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi.
3. Me qëllim kryerjen e transfertave të përcaktuara në këtë udhëzim, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:
- a) kërkesën sipas pikës 1.1. gërma a të udhëzimit nr. 1;
 - b) vërtetimin (në rast se është e mundur), nga një organ kompetent, që justifikon qëllimin e veprimit sipas këtij udhëzimi;
 - c) vërtetimin nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore për personat fizikë dhe juridikë.

RREGULLORE

PËR LICENCIMIN E ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR

Zyra e këmbimit valutor është një nga operatorët e tregut të këmbimeve valutore, e cila për llogari të saj blen dhe shet valutë dhe çeqe udhëtarësh.

Licencimi i zyrës së këmbimit valutor bëhet nga Banka e Shqipërisë sipas kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore.

I. Kërkesa të përgjithshme

1. Për subjektet, që kërkojnë të kryejnë veprimtarinë e këmbimeve valutore, shuma minimale e kapitalit fillestar të kërkuar, të regjistruar (në gjykatë) dhe të paguar si kontribut në para, është 2.500.000 lekë. Subjektet duhet të depozitojnë shumën e kapitalit minimal prej 2.500.000 lekësh ose ekuivalenten e saj në çdo monedhë tjetër, llogaritur me kursin e bankës në ditën e depozitimit, në një llogari të bllokuar, pranë një banke ose dege banke të huaj në Republikën e Shqipërisë, që zhbllokohet vetëm me marrjen e licencës së zyrës së këmbimit valutor nga Banka e Shqipërisë. Në rast të refuzimit të dhënies së licencës, Banka e Shqipërisë lëshon një dokument për zhbllokimin e llogarisë përkatëse.

2. Subjektet e interesuara paraqesin në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën për licencimin e zyrës së këmbimeve valutore, personat që do të ushtrojnë këtë aktivitet, kualifikimin e tyre dhe adresën e saktë të zyrës ose të zyrave të këmbimit valutor, në rastet kur veprimtaria e këmbimeve valutore do të kryhet në disa degë të saj; kualifikimin e administratorit të shoqërisë (dokumentin që vërteton se të paktën ka përfunduar shkollën e mesme).

b) vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik, statutin, si dhe aktin e themelimit të shoqërisë tregtare, ku të jetë regjistruar veprimtaria e këmbimeve valutore.

Në rast se shoqëria ka ndryshime në personin juridik që nga regjistrimi fillestar, të paraqiten dokumentet, që vërtetojnë ndryshimet e bëra.

c) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor të rrethit, për vitin ushtrimor, për kryerjen e veprimtarisë së këmbimeve valutore.

d) Vërtetimet nga gjykata, prokuroria e rrethit dhe Ministria e Drejtësisë se personi ose personat, që do të ushtrojnë veprimtarinë e këmbimeve valutore nuk kanë kryer ndonjë vepër penale ose nuk janë në gjykim ose ndjekje penale.

e) Dokumentin, që vërteton pronësinë ose marrjen me qira të lokalit, ku do të kryhet veprimtaria e këmbimeve valutore.

f) Deklaratën noteriale të subjektit, se nuk ka detyrime ndaj bankave, ndaj degëve të bankave të huaja dhe ndaj institucioneve të tjera kredidhënëse.

g) Vërtetimin, nga një bankë ose degë banke e huaj, se subjekti ka llogari rrjedhëse në valutë

dhe në lekë, pranë saj.

h) Vërtetimin nga një bankë ose degë banke e huaj se subjekti ka depozituar në një llogari, të marrë si garanci, shumën minimale të kapitalit të kërkuar sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

i) Dy fotografi për çdo punonjës të caktuar për kryerjen e veprimtarisë së këmbimeve valutore.

k) deklaratën noteriale të shoqërisë, se dokumentacioni i paraqitur është i vërtetë.

3. Dokumentacioni të jetë në origjinal ose në kopje të noteruar dhe në gjuhën shqipe, si për vendasit dhe për të huajt.

4. Dokumentacioni i plotë të dorëzohet, në zarf të mbyllur ose të postohet në adresën e mëposhtme:

Banka e Shqipërisë

Departamenti i Mbikëqyrjes

Spektori i Licencimit dhe Rregullimeve Bankare

Sheshi "Skënderbej" Nr.1

Tiranë.

II. Verifikimi i dokumentacionit dhe afatet

1. Banka e Shqipërisë organizon verifikimin e dokumentacionit të paraqitur dhe nëse ai nuk është i plotë dhe nuk përmbush kërkesat e këtij udhëzimi, njofton kërkesit brenda 15 ditëve pas paraqitjes së tij. Po brenda këtij afati, Banka e Shqipërisë, nëse e gjykon të nevojshme, ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë.

2. Mungësitë në dokumentacionin e paraqitur të mënjanojnë brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga Banka e Shqipërisë. Në qoftë se dokumentacioni nuk plotësohet pas kalimit të këtij afati, Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës.

3. Pas verifikimit të dokumentacionit, Banka e Shqipërisë inspekton ambientet ku është caktuar të zhvillohet veprimtaria e këmbimeve valutore. Nëse kushtet teknike janë të përshtatshme për kryerjen normale të veprimtarisë së këmbimeve valutore, merret vendimi përfundimtar për dhënien ose jo të licencës. Për vlerësimin e kushteve teknike të zyrës së këmbimeve valutore në inspektim merr pjesë një specialist i Spektorit të Sigurimit të Bankës së Shqipërisë.

4. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon licencën për zyrë të këmbimeve valutore, brenda 30 ditëve kalendarike pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë.

5. Banka e Shqipërisë së bashku me licencën jep edhe kartën e identifikimit për çdo kambist të licencuar që do të punojë në zyrën e këmbimit valutor.

6. Banka e Shqipërisë, brenda tre ditëvepune pas marrjes së vendimit nga administratorët e Bankës së Shqipërisë, i dorëzon licencën kërkesit ose njofton me shkrim për refuzimin e kërkesës për licencë. Në rast refuzimi të kërkesës, kërkesi ka të drejtë ankimi tek Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

7. Licencimi jepet i pakufizuar në kohë dhe nuk është i transferueshëm.

8. Brenda datës 31 mars të çdo viti, zyrat e këmbimeve valutore, paraqesin në Bankën e Shqipërisë, dokumentet e përcaktuara në pikën I.2. b, në rast se ka ndryshime dhe I.2.c.

9. Brenda 15 ditëvepune pas paraqitjes së dokumentacionit sipas pikës 8, Banka e Shqipërisë, bën njoftimin për vlefshmërinë ose jo të licencës së dhënë për vitin në vazhdim. Nëse dokumentet e kërkuar sipas pikës 8, më sipër, nuk janë dorëzuar në Bankën e Shqipërisë brenda datës 31 mars të çdo viti, licenca e dhënë zyrës së këmbimit valutor bëhet e pavlefshme dhe Banka e Shqipërisë njofton revokimin e saj.

III. Detyrimet e zyrës së këmbimeve valutore

1. Zyra e këmbimeve valutore duhet të fillojë veprimtarinë e saj brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e licencës.

2. Të gjithë punonjësit, që kanë kontakt të vazhdueshëm me klientët, duhet të mbajnë në vend të dukshëm kartën e tyre të identifikimit. Ndryshimet e personelit të zyrës së këmbimeve valutore, i njoftohen Bankës së Shqipërisë brenda 15 ditëvepune për pajisjen e tyre me kartë identifikimi. Për personat e larguar dorëzohet karta e identifikimit.

3. Të njoftojë menjëherë Bankën e Shqipërisë për ndryshimin e adresës së zyrës së këmbimeve valutore të licencuar.

4. Të afishojë në vend të dukshëm kursin ditor të këmbimeve valutore, në blerje dhe në shitje

për çdo valutë.

5. Për çdo këmbim valutor, të lëshohet dokumenti i veprimit të kryer dhe të mbahet një kopje e tij.

6. Të raportojë çdo ditë në Bankën e Shqipërisë, për veprimet e këmbimeve valutore të kryera, sipas udhëzimit 4 të kësaj rregulloreje.

7. Të organizojë kontabilitetin në përputhje me ligjin nr.7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin".

IV. Revokimi i licencës

Përveç rasteve të shkeljes së kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë ka të drejtën e revokimit të licencës edhe kur:

1. provohet se një prej dokumenteve kryesore të paraqitura për marrjen e licencës është fals;
2. zyra e këmbimeve valutore ose e ka ndërprerë veprimtarinë për një periudhë më të gjatë se 30 ditë kalendarike, pa njoftuar më parë me shkrim, Bankën e Shqipërisë;
3. gjatë kryerjes së veprimtarisë, konstatohen sjellje të pandershme ose mashtrime;
4. vërtetohen shkelje në mbajtjen e kontabilitetit.

Brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit për revokimin e licencës nga administratorët e Bankës së Shqipërisë, zyra e këmbimeve valutore, të dorëzojë dokumentin e licencës në Bankën e Shqipërisë.

V. Komisionet

Pagesa paraprake për marrjen e licencës është 2500 lekë.

Pagesa për kartën e identifikimit, për çdo person të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë së këmbimeve valutore është 500 lekë.

Këto pagesa kryhen në Bankën e Shqipërisë.

VI. Dispozita e fundit

Kjo rregullore u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.65, datë 30.7.2003 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Shkëlqim Cani

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit "Ndërtim i kanalit të ujërave të larta, Kotë, Vlorë".

Subjekti kërkuar i këtij objekti është komuna Kotë, Vlorë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person sipas listës emërore të mëposhtme.

Lista e pronarëve që do të shpronësohen për ndërtimin e kanalit të ujërave të larta në Komunën Kote Vlorë

Nr	Emri, mbiemri	Sip/ tokë Bujqës ore m2	Çmimi për m2	Sip/tokë ë truall m2	Çmimi për m2	Dru frutore	Çmimi	Hardhi rrënjë	Çmimi	Jonxhë Sip.m2	Çmimi për m2	Vlera në total (lekë)
1	Trashëgimtarët e Memisha Myrtaj Neki Myrta Hariz Myrta Feti Myrta Tefide Myrta Emine Dapaj Gjergji Myrta Perlat Myrta			1833	900	11	2000			1257	20	1 696 840

2	Enver Myrta Jahja Myrta Enver Muhamed Myrtaj			350	900	11	2000	16	3000			385 000
3	Perlat Muhamet Myrtaj	525	500							525	20	273 000
4	Bilbil Shefit Likaj	350	500							350	20	182 000
5	Astrit Haxhi Memaj Gjithsej	875	500							870	20	454 900
												2 991 740

KËRKESË

Shtetasi Qemal Ibrahimimi lindur dhe banues në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasve Aida Ibrahimimi, Alda Ibrahimimi dhe Erkan Ibrahimimi.

KËRKUESI
Qemal Ibrahimimi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 8.8.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë